Janë pregatitur gjithashtu disa urdhëra dhe vendime të Kryetarit të Bashkisë për problematika të ndryshme të cilat lidhen me Drejtori dhe sektorë të tjerë të Bashkisë si dhe rregullore të ndryshme në funksion të realizimit të procedurave të veprimtarisë së administratës së Bashkisë me autorizimin e Kryetarit të Bashkisë nga specialistët e Drejtorisë Juridike është përfaqësuar Bashkia Vlorë dhe institucionet e varësisë së saj në proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjyqimit në cilat është thirrur si palë e paditur si dhe janë pregatitur kërkesë paditë kur vet Bashkia Vlorë ka inicuar proceset gjyqësore vecanërisht në zbatim të detyrave të lëna nga KLSH ose Institucione të tjera të Auditimit. Gjatë vitit 2025 kanë nisur procedurat gjyqësore për 30 çështje kryesisht të inicuar nga palët e treta kundër bashkisë Vlorë ose Institucioneve në varësi të saj të cilat janë ndjekur rregullisht nga specialistet e drejtorisë juridike. Gjithashtu janë mbi 200 çështje të tjera gjyqësore në vijim nga vitet e kaluara në shkallë të ndryshme të gjyqësorit të cilat datojnë që prej vitit 2009. Sikurse trajtuam veç çështjeve të filluara gjatë këtij viti janë ndjekur nga Drejtoria Juridike të viteve të kaluara shumë çështje të cilat janë duke u shqyrtuar nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Administrative e Apelit ose Gjykata e Lartë që presin të shqyrtohen si dhe çështje që pasi janë ankimuar janë risjellë përsëri për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Civile ose Administrative.

Fakti që theksuam më lart sipas të cilit shumë çështje janë në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë si dhe shumë çështje janë ankimuar ose janë kthyer për rigjykim mbi bazën e ankimit të Bashkisë dhe vazhdojnë prej shumë vitesh për një vendim përfundimtar e konfirmon këtë konstatim.

Objekt i çështjeve gjyqësore ka qënë lidhur me problematika të ndryshme si kundërshtim vlere shpronësimi nga projektet e shumta në infrastrukturë, marrëdhënie pune, shlyerje detyrimesh për procedurat tatimore etj. Nga këto, mund të veçojmë si më të vështira për tu mbrojtur çështjet e vlerës së shpronësimit të pasurive pronë private të prekura nga projektet në Infrastrukturën Publike si dhe marrëdhëniet e punës.

Kjo pasi gjatë procedurës së shpronësimit llogaritja e vlerave përkatëse është bërë sipas çmimeve të references bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ndërkohë që nga pronarët pasuritë e të cilëve janë shpronësuar është kërkuar nëpërmjet gjykatës llogaritja e vlerës sipas çmimeve të tregut. Mund të themi se ka pasur raste që gjykatat kanë pranuar paditë pavarësisht pretendimeve tona. Theksojmë se në procedurat e shpronësimit Bashkia ka kryer vetëm vlerësimin paraprak pasi vendimi përfundimtar është i Ministrisë përkatëse. Theksojmë se Vendimet e Gjykatës me detyrime financiare për Bashkinë janë në tërësi vendime të Gjykatës së Apelit pasi në çdo rast vendimet e Gjykatës së shkallës së Parë janë ankimuar.

Në punën e Drejtorisë Juridike vëmendje të veçantë ka pasur korrespondenca dhe komunikimi me Institucione të tjera shtetërore dhe përgjigjeve për kërkesat e qytetarëve sipas problematikës për të cilën është adresuar për zgjidhje Drejtoria Juridike. Në të gjitha rastet përgjigja ka qënë e përgjegjshme bazuar dhe në dispozitat ligjore në fuqi si dhe brënda afateve të parashikuara në ligjin “Për të drejtën e informimit”.

Mund të themi se nga mbi 20 kërkesa dhe ankesa të adresuara Drejtorisë Juridike gjatë kësaj periudhe nuk ka _____

pasur çështje të pasqaruara për të cilat qytetarët t'i jenë drejtuar gjykatës ose organeve të tjera shtetërore në lidhje me Bashkinë Vlorë pasi kanë komunikuar direkt me Drejtorinë Juridike .

Gjithashtu i është dhënë përgjigje në kohë çdo çështjeje që lidhet me Drejtorinë Juridike portalit të bashkëqeverisjes si dhe është bashkëpunuar me Drejtorinë, Sektorët si dhe institucionet e tjera të varësisë për përgjigjet e ankesave drejtuar këtij portali.

Veç përgjigjeve për kërkesa dhe ankesa janë pajisur qytetarët mesatarisht çdo ditë rreth 10 vërtetime ose konfirmime të ndryshme sipas problematikës së paraqitur prej tyre. Në raste të tilla është synuar të pajisen në çast edhe pse afatet mund të ishin disa ditore.

Theksojmë se puna ditore e specialistëve të Drejtorisë Juridike është kryer në bashkëpunim, edhe me Drejtorinë e tjera për plotësimin e dokumentacionit shkresor sipas problematikës së krijuar rast pas rasti.

Drejtoria e Urbanistikës

Në analizën e punës së Drejtorisë së Urbanistikës, për periudhën Janar-Prill 2025 janë marrë në konsideratë disa faktorë të ndryshëm, të cilët përcaktojnë prioritetet e drejtorisë, evidentimin e problematikave të ndryshme që mund të hasen gjatë kryerjes së detyrave funksionale, trajtimin e kërkesave dhe ankesave që mund të vijnë nga qytetarët apo subjektet e interesuara, ushtrimin e detyrave funksionale në sistemin e lejeve në funksion të aplikimeve etj. Më poshtë po listojmë veprimtarinë e Drejtorisë së Urbanistikës:

A. Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Vlorë, prej periudhës Janar-Prill 2025 ka kryer detyrat si më poshtë vijon:

1. Të ardhura nga Taksa e Infrastrukturës për periudhën Janar – Prill 2025

Gjatë punës në sektorin e kontrollit të lejeve të ndërtimit, është bërë i mundur arkëtimi i vlerës **totale 877 877 lekë** si taksë e ndikimit në infrastrukturë dhe të ardhura të tjera për çdo leje ndërtimi të miratuar, ku përfshihen llojet e lejeve si më poshtë:

- Certifikatë Përdorimi
- Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m²
- Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni
- Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²
- Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m²
- Leje për ndryshim aktiviteti/funksioni
- Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit
- Deklaratë Paraprake Punimesh

2. Projektet Publike Infrastrukture

A - Janë përfunduar këto projekte për investimet e parashikuara për

Buxhetin 2025

- 1-Rikonstruksioni i Kopshtit “1 Maj”
- 2-Rikonstruksioni i bllokut te banimit prane Sigurimeve Shoqërore
- 3-Rikonstruksioni i trotuareve pergjate rruges Transballkanike
- 4-Rikonstruksioni i shkalleve ne “ Kuzum Baba”
- 5-Rikonstruksion Rruga “ Zenel Gjoleka” (te Ujësjellesi)
- 6-Rikonstruksion rruget Panaja me ndricim + kënd sportiv
- 7-Rikonstruksion Rruget e brendshme Sherishte
- 8-Rikonstruksion rruga e varrezave ne Risili
- 9-Rikonstruksion rruga “Jul Qezari” ne Orikum
- 10-Kënd sportiv në Orikum
- 11-Mobilim i shkolles “Lef Sallata”
- 12-Mobilim shkolla Avni Rustemi
- 13-Rikonstruksion i hapesirave rekreative
- 14-Rikonstruksion i banesave sociale

3.Hartimi i PDV-ve

Gjatë periudhës Janar- Prill 2025 sektori i Planifikimit të Territorit ka përfunduar fazën e parë të hartimit të Planit të Detajuar Vendor, në njësinë strukturore:

- VL.UB.6.1384

4.Korrespondenca shkresore

Gjatë periudhës Janar-Prill 2025 pranë Drejtorisë së Urbanistikës janë administruar dhe trajtuar **përafërsisht 27** shkresa në javë nga institucione, qytetarë dhe subjekte fizike apo juridike.

5.Sistemi i adresave(Adresari)

Gjatë muajve Janar-Prill 2025 janë paraqitur mesatarisht 20 - 25 qytetarë në ditë, duke përfshirë edhe disa qytetarë me kombësi të huaj. U është ofruar shërbimi për saktësim adrese apo konfirmim adrese për

ndryshim vendbanimi. Gjithashtu në bashkëpunim të vazhdueshëm me Gjendjen Civile ndërhyjmë në rregullimin e pasaktësive në Sistemin e Adresave.

Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve

1. Në zyrën e administrimit dhe mbrojtjes së tokës të Bashkisë Vlorë, pjesë e DPPMA-së, në zbatim të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së 1182, datë 24.12.2020, “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore”; VKM-së 1174 të VKM –së Nr.1174, datë 24.12.2020, “Për procedurat e regjistrimit të amtp-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese”; është punuar në raport me praktikën e fermerëve duke plotësuar dhe dërguar në ASHK, Dv-Vlorë dosjen përkatëse të çdo fermeri.

Situata e praktikave të aplikuara nga fermerët dhe të trajtuara nga kjo zyre është si më poshtë, për periudhën 01.01.2025-30.04.2025

Nr	Njesitë Administrative	Numri i shkresave të punuara	
1	Ish Bashkia Vlore	48	
2	Nj.Administrative Novoselë	10	
3	Nj.Administrative Qendër	14	
4	Nj.Administrative Orikum	13	
5	Nj.Administrative Shushicë	18	
6	SHUMA	104	

Këto shkresa janë praktika të dërgimit të dosjeve të tokave në përdorimit të cilat dërgohen në ASHK për kalimin në pronësi si dhe praktika të regjistrimit të AMTP-ve në zbatim të VKM-së 1174/2020.

Në ndjekje të procedurave të kalimit nga përdorimi në pronësi në zbatim të VKM-së 1182/2020, në bashkëpunim me zyrën e ASHK, Dv-Vlorë janë verifikuar dhe janë mbajtur Akt –konstatime për 78 subjekte prej të cilëve janë dërguar për shpallje në bashki 17 (Shtatëmbdhjet) praktika nga të cilat 9 praktika kanë mbushur afatin 30 ditësh dhe është përgatitur shkresa e përfundimit të shpalljeve për në ASHK. Pjesa tjetër është në proces shpallje.

Vec sa më lartë në këtë zyrë janë mbajtur edhe korespondenca me institucionet e treta, si gjykat, prekurori, Qark, ATP etj.

Në vijim të punës tonë si zyrë për këtë periudhë, janë trajtuar edhe kërkesat për vërtetime të ndryshme si dhe për vjeljen e taksës së tokës bujqësore në zbatim të ligjit.

Në DPPMA është administruar shkresa me nr.389 prot., datë 23.04.2025 e Njesisë Administrative Qendër e cila kërkon Azhonimin e tokave bujqësore në zonat kadastrale 1060, 1061 dhe 3858, përkatësisht Babic e Madhe, Babicë e Vogël dhe Xhyherinë. Referuar kërkesës dhe shqetësimit që kanë banorët dhe ne si institucion ngelet në vijim duke ju referuar eksperiencave të Bashkive të tjera, (Referuar Bashkisë Sarandë), të rakordohet me ASHK, Dv-Vlorë dhe me Këshillin Bashkisë për financimin dhe ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektit të menaxhimit të tokave bujqësore në zonat kadastrale të cilat nuk ka kaluar menaxhimi dhe nuk është bërë regjistrimi fillestar.

Vlen për tu theksuar problematikat e shumta që lindin me ASHK-në si rezultat i perditësimit të pasurive të tokave bujqësor.

Në raport me punën e kësaj zyre shqetësim janë vonesat brenda institucionit si rezultat e delegimit, konfirmimit nga personat e autorizuar dhe shpërndarjes me vonesë të praktikave.

- 1- T'ju shërbehet në kohe dhe brenda afateve ligjore kërkesave të institucioneve dhe qytetarëve
- 2- Në vijimësi të përditësohet dërgimi i praktikave të ngelura për regjistrim të AMTP-ve dhe për kalim në pronësi të tokave bujqësore në zbatim të ligjit 20/2020 dhe VKM-ve 1174/2020 dhe 1182/2020 duke i dërguar në gjëndjen që janë në ASHK.
- 3- Të përditësohen evidencat e DAMT të Qarkut cdo gjasht mujor
- 4- Praktikrat që janë gjëndje në Njësitë Administrative të dërgohen zyrtarisht në DPPMA të Bashkisë Vlorë në gjëndjen që janë.
- 5- Të hartohet një program pune për përgatitjen e materialit për menaxhimin e zonave sipas kërkesës së Njesisë Administrative Qendër.

2. Në sektorin e inventarizimit dhe regjistrimit të Pronave të Paluajtshme

Kryetari i Bashkisë Vlorë me Urdhërin e Brendshëm Nr.371 datë 11.09.2024, protokolluar me Nr.14036 prot datë 11.09.2024, "Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e dokumentacionit ligjor e teknik për procedurën e inventarizimit të pronave shtetërore", ka ngritur grupet e punës, të cilat kanë vijojuar me hartimin e dokumentacionit ligjor e teknik për procedurën e inventarizimit dhe transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore, në pronësi të Bashkisë Vlorë.

Aktualisht janë aplikuar 65 praktika për institucionet arsimore në qytet. Për 51 praktika kemi marrë konfirmimet nga ASHK.

DPPMA ka hartuar materialin ligjor dhe teknik për projekt vendimin për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme), të pronave të pronave paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë, të Qarkut të Vlorës" për 51 prona., miratuar nga Keshilli i Bashkisë Vlorë me Vendim nr.30 datë 29.04.2025.

Me shkresën nr.460/1 prot datë 07.05.2025, është miratuar shprehja e ligjshmërisë nga Prefektura e Qarkut Vlorë, për aktin më sipër dhe DPPMA do të vijojë korespondencën me Agjencinë e Inventarizimit të Pronave Publike (AITTP), plotësimin e formularëve sipas modelit të miratuar me

udhëzimin nr.1, datë 15.02.2002 të AITTP-së për përgatitjen e kërkesës për miratimin e listës përfundimtare pranë AITTP-së.

Ndërkohë po vijojmë me pronat që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë. Aktualisht grupet e punës janë duke përgatitur dokumentacionin edhe për 100 pasuri të tjera, për ti kaluar për vendim Këshill Bashkie.

- Për objektet që kanë VKM kalimi pronësie në favor të Bashkisë Vlorë

Kemi aplikuar në ASHK Vlorë, për regjistrim për VKM Nr.915, datë 11.11.2015 “Për transferimin në pronësi, nga Këshillat e Qarqeve të Bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të Aseteve të Luajtshme e të Paluajtshme të Ndërmarrjeve të Mirëmbajtjes së këtyre rrugëve, për objektin me nr pasurie 23/160, Zk 8602 “**Ndërmarrja e rrugëve Rurale Vlorë**”.

Bashkia Vlorë, ka aplikuar pranë ASHK Vlorë, me Nr.44077, datë 17.12.2024 aplikimi, për regjistrimin e pasurisë 23/160, zk 8602, në zbatim të VKM Nr.915 datë 11.11.2025.

Është plotësuar i gjithë dokumentacioni ligjor dhe teknik në lidhje me këtë aplikim dhe është ngarkuar i plotë në sistemin e-albania për, ASHK Vlorë.

Kjo praktikë për regjistrim i është bërë me dije edhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë dhe Drejtorisë së Pronave Shtetërore Tiranë.

Nga ana e këtyre institucioneve me shkresat nr.524 prot datë 13.01.2025 dhe nr.14194/1 prot datë 24.12.2024, ju është kërkuar të trajtohet kërkesa më sipër.

ASHK Vlorë ka kthyer përgjigje që në lidhje me aplikimin 44077 datë 17.12.2024 ka konstatuar se aplikimi nuk është i shoqëruar me dokumentet e mëposhtëme:

- 1.Dokument shtesë , i domosdoshem në bazë të ligjit 111/2018
2. Bashkia nuk legjitimohet për shërbimin e kërkuar.

Pra ASHK Vlorë, nuk ka vijuar me çertifikimin e pasurisë subjekt vkm 915/ 2015.

4.Me VKM 541 DATË 27.07.2016 “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Vlorë , të pronës me sipërfaqe 371m2 truall, pjesë e pronës me nr.17, me mërtimin “Rezidenca qeveritare Vlorë, dhe për një ndryshim në Vendimin nr.1058, datë 16.07.2008, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave , për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, të ndryshuar.

Aktualisht është aplikuar për shërbimin kartelë dhe HTR , për vijimin e procedurës. Sapo të pajisemi me dokumentacionin lidhor do të vijojmë me aplikim për çertifikatë pronësie,

5.Me VKM 850 Datë 15.12.2006 “Për transferimin në pronësi, disa Bashkive, të pronave, që janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të shërbimit social shtetëror, dhe për disa ndryshime në vendimin nr.60 datë 01.02.2006, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit

të pronave të paluajtshme shtetërore të cilati kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Social Shtetëror”, Bashkisë Vlorë sipas pikës d) i ka kaluar në pronësi objekti me nr rendor 23 m që përkon me “Qendrën e Shërbimeve për Persoant me aftësi të kufizuar” Vlorë

Aktualisht është aplikuar për shërbimin kartelë dhe HTR , për vijimin e procedurës.

Sapo kemi marrë përgjigje nga ASHK për kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe fragmentin e hartës kadastrale dhe jemi duke drejt procesit për aplikim për çertifikimin e pasurisë pasurinë 24/1-T dhe 24-nd.

Këtë material e kemi kaluar në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë për saktësim.

6. Me VKM 227 datë 19.04.2006 ”Për Transferimin e truallit dhe të objektit “Hidrovari i qytetit Vlorë” nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorti , në pronësi të Bashkisë së Vlorës.

Për këtë VKM, kemi konstatuar mospërputhje të mëdha në sipërfaqe si për truallin ashtu edhe për ndërtesën.VKM -të përgjithësisht nuk janë të shoqërara me planvendosje.

Për këtë rast i jemi drejtuar zyrtarisht Ministrisë së Bujqësisë, për informacion. Pas marrjes së përgjigjes zyrtare do të vijojmë me aplikimet përkatëse.

7. Me VKM 221 DATË 17.04.2019 “Për kalimin në pronësi të BASHKISË Vlorë, të pronës me emërtimin Bashkia me vendndodhje në zonën kadastrale 8605”, Bashkisë Vlorë i është dhënë e drejta për çertifikimin e godinës.

Bashkia Vlorë ka aplikuar për pasuritë 40/53 dhe 40/55. Nuk po marrim shërbim nga ASHK Vlorë.

9.Me VKM 1108 DATË 30.12.2015 ‘Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë , Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave të Bashkitë, të infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve Rajonale të Kullimit, Bashkisë Vlorë i është dhënë e drejta për regjistrim.

Nga matjet faktike shikojmë se ka problematika me sipërfaqet e matura të objekteve dhe të truallit.

Janë bërë aplikimet për tu njohur me gjendjen juridike dhe kufijtë e pronës dhe mandej pas rregullimit të sistuatës ligjore dhe faktike do të vijojmë me praktikën.

10. Me VKM nr.114 datë 13.02.2020 “Për kalimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Vlorë, të një pjese të truallit funksional , brenda territorit të pronës nr.912 me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve” me vendndodhje në Vlorë dhe për një ndryshim në vkm nr.515 datë 18.07.2003, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi, Ministrisë së Mbrojtjes të ndryshuar, Bashkisë Vlorë i ka kaluar 400 m2 truall , ende pa aplikuar për çertifikim.

11. Me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Vlorë , sipërfaqe truall dhe ndërtesë për Hangarët në lagjen “Kushtrimi”.

Eshtë aplikuar për pasurinë 3/103 për kartelë dhe Fragment harte kadastrale , për të vijuar me tej praktikën për çertifikim.

Sqarojmë se:

1. Të gjitha VKM-të për transferim nuk janë të shoqëruara me planvendosje, fakt që vështirëson punën për përputhjen e kufirit të pronës me faktin.

Kjo vlen për të dy grupet e pronave, si për grupin e pasurive me VKM transferimi ashtu edhe për grupin e pronave për VKM inventarizimi për Bashkinë Vlorë dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore

2. Kanë ndryshuar numrat e pasurive ndër vite, sidomos për zoneën e Ujit të Ftohtë, e cila është e menaxhuar dhe pronat kanë marrë numër pasurie tjetër.

3. Siperfaqet e objekteve dhe të truallit kanë mospërputhje.

4. Shërbimi nga ASHK, nuk ofrohet në kohë, madje në shumicën e aplikimeve, përgjigjet janë jo korrekte.

5. Në Njësitë Administrative një pjesë e zonave kadastrale janë të pamenaxhuara, fakt që pamundëson procesin, pasi planet e rilevimit duhen në KRRGJSH, sipas formatit ligjor me VKM 782/2020.

6. Ka marzh të madh gabimi midis hartave të ASHK dhe atyre të ALUIZNIT, fakt që sjell mospërputhje të kufijve të pronësive.

Shërbimet nga ASHK, nuk ofrohen në kohë, ose nu ofrohen fare. Mendojmë organizimin e një takimi të përbashkët me drejtuesit e ASHK për të mundësuar një bashkëpunim më të mirë.

3.Në sektorin e shpronësimeve

Spektori i shpronësimeve funksionon në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar dhe VKM-së nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik“, i ndryshuar. Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve harton dosjen me dokumentacionin e nevojshëm, për të paraqitur më tej kërkesën për shpronësim publik, pranë ASHSH Tiranë.

- Aktualisht jemi në fazën e publikimit të VKM për shtesa të VKM-së nr.20 datë 24.01.2024 “Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar” Vlorë
- Përfundoi VKM 136 datë 06.03.2025 “Për shtesa të VKM-së nr.414, datë 27.05.2020 “Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Menaxhim i integruar i mbetjeve të ngurta të rajonit të Vlorës”, Bashkia Vlorë.
- Është në procedurë shpronësimi projekti “Leje rikonstruksioni të ndërtesës së dëmtuar, pa shtim apo ndryshim volumi për projektin përforcimi i pallatit 1300” Vlorë, bazuar në shkresën nr.871 prot datë 20.01.2025

4.Spektori i plazheve dhe menaxhimi i sipërfaqeve publike

Për këtë periudhë janë përgatitur planvendosjet sipas VKM 649 datë 16.10.2024, për 98 stacione plazhi .Në vazhdimësi të miratimit të kontratave të plazhit , po bëhet piketimi dhe dorëzimi i stacioneve të plazheve.

Për koridoret ujore janë paraqitur 10 kërkesa.Kemi bërë takime me policinë kufitare , Autoritetin Portual dhe AKB për shqyrtimin e kërkesave të operatorëve turistikë, sipas urdhërit Nr.535 datë 23.12.2024 të Kryetarit të Bashkisë.Deri tani nuk është konkluduar me institucionet e mësipërme, pasi nuk kanë burime njerëzore për të kontrolluar koridoret ujore si dhe vazhdimi i punimeve të projektit Lugomare 3, bën të pamundur përcaktimin e hartës për koridoret ujore.

Për menaxhimin e sipërfaqeve publike (SPL) , për këtë periudhë, janë miratuar 41 akt marrëveshje të tilla, me 3062 m2.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Veprimtaria në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore bazohet në: Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjin Nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjin Nr. 9131, datë 8.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Ligjin Nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 138/2015, datë 17.12.2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Me VKB nr. 101, datë 03.12.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të deleguara - 2025”, VKB nr. 102 datë 18.12.2024 “Për krijimin e Ndërmarrjes së Pastrimit dhe Ndërmarrjes së Gjelbërimit në vartësi të bashkisë Vlorë dhe për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2025” është miratuar niveli i pagave dhe numri i punonjësve i cili është:

Në administratën e Bashkisë Vlorë – 406 pozicione, në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike - 396 pozicione, në Qendrën Kulturore - 28 pozicione, në Teatrin Petro Marko - 30 pozicione, në Klubin Shumësportësh “Flamurtari” - 18 pozicione, në Qendrën e Zhvillimit PAK - 22 pozicione, në Ndërmarrjen Publike për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane - 39 pozicione, në Qendrën e Shërbimeve me Baze Komunitare për Femijet me Aftësi të Kufizuara - 11 pozicione.

Pjesë e kësaj strukture janë edhe funksionet të transferuara në Bashkinë Vlorë pas Reformës Territoriale: Arsimi parashkollor / punonjësit jomësor (sistemi 9 vjeçar) - 355 punonjës, Arsimi i mesëm punonjes jomesor - 51 punonjes, Sektori Bordit të Kullimit - 17 punonjës, Sektori e Pyjeve dhe Kullotave - 6 punonjës, Sektori e Rrugëve rurale - 5 punonjës, Sektori i MNZSH - 50 punonjës.

Me VKB nr. 20 datë 25.02.2025 "Për miratimin e ngritjes së Qendrës ditore për të moshuarit" është miratuar ngritja e qendrës ditore të të moshuarve dhe është miratuar struktura e përbërë prej 4 pozicionesh.

Në këto struktura ka pozicione të Shërbimit Civil, ndihmës/mbështetës dhe funksionarë politik.

Bazuar në ligjin 152/2013 "Për nëpunësin civil" për periudhën 01.01.2025 – 31.04.2025 janë shpallur 3 procedura konkurrimi për pozicione të Shërbimit Civil të cilat kanë përfunduar me fitues. Në përfundim të procedurave janë kryer 3 emëtime si nëpunës civil me procedura konkurimi sipas Ligjit të Shërbimit Civil në pozicione të kategorisë së mesme drejtuese.

Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Në vijim të shkresës me nr. 7136 Prot, datë 07.05.2025, hyrë në Drejtorinë e MZSH-së, Bashkia Vlorë me nr.203 Prot, datë 12.05.2025 dhe në zbatim të Ligjit 152/2015 e VKM-së nr.520 datë 25.07.2019 për shërbimin zjarrfikës, ju dërgojmë si më poshtë vijon analizën e punës për periudhën 01.01.2025 – 30.04.2025 të Drejtorisë së MZSH-së, Bashkia Vlorë.

Për periudhën 01.01.2025 – 30.04.2025 është realizuar puna dhe siguruar gatishmëria në njohjen e bazës Ligjore, Urdhërave dhe Udhëzimeve si dhe Postës Elektronike ardhur nga Dreitoria e Përgjithshme e MZSH-së në Ministrinë e Brendshme, Bashkia Tiranë. Është punuar dhe zbatuar plani i masave për përforsimin dhe rritjen e gatishmërisë për sezonin pranvere-verë me efektivët e ndërhyrjes operationale.

Spektori i Ndërhyrjes ka përpiluar dokumentacionin ligjor për muajin 01.01.2025 – 30.04.2025 si dhe është përgjigjur në kohë për fikjen e zjarreve dhe problematikave të tjera.

Spektori i Parandalimit ka marrë masa për programimin e punës për muajin 01.01.2025 – 30.04.2025, më konkretisht për kontrollin dhe masat parandaluse që kanë marrë të gjitha hotelëritë në vijën bregdetare të Bashkisë Vlorë, verifikimin dhe ndarjen e objekteve sipas rrezikshmërisë në kategori bazuar në aktet ligjore në fuqi.

Spektori i Parandalimit gjatë periudhes 01.01.2025 – 30.04.2025, në bazë të planeve të punës të hartuara ka ushtruar kontrole rutinë dhe të programuara në subjekte publike dhe private si hotelëri, objekte didaktike shkollë, kopshte çerdhe dhe në subjekte me aktivitet shërbimi.

Është ndjekur në vazhdimësi gjatë periudhes 01.01.2025 – 30.04.2025 gatishmëria e Sektorit të Ndërhyrjes duke u mbështetur në organizimin e shërbimit sipas grafikut të shërbimit, librave të planëzuara dhe situatave të paparashikuara, duke ushtruar kontrole të drejtpërdrejta në Stacion.

Vëmendje kryesore dhe e veçantë i është kushtuar gadishmërisë në efektivë dhe mirëmbajtjes së automjeteve zjarrfikëse, paisjeve dhe materialeve të tjera ndihmëse për zjarrfikësen.

Kemi bashkëpunuar me Drejtorinë e Emergjencave Civile në Bashkinë Vlorë dhe Emergjencat Civile në Prefekturën e Qarkut Vlorë. Tabela përmbledhëse e sektorit të Ndërhyrjes Operacionale si më poshtë:

	Objekt e Civile banimi	Objekte,aktivitete shërbimi dyqane,salla,magazina etj.	Objekte akomoduese turistike	Objekte Didaktike shkolla,kopshte,çerdhe	Objekte ku tregtohen lëndë lehtësisht të djegshme	Objekt e me aktivitet administrativ e	Objekte me rrezik të shtuar(uzina ,fabrika të perpunimit të lëndëve djegëse)	Mjete transporti	Kullota,pyje,shkurre,barishte,plehura	Ndërhyrje për shpëtim	Alarme falsë	Nuk ka qenë e nevojshme ndërhyrja	Total
ANAR	2	-	-	-	-	-	-	2	19	22	-	3	48
SHKURT	3	-	-	-	-	-	-	5	21	11	-	4	44
PARAS	4	-	-	-	-	-	-	3	78	8	-	3	96
RILL	2	-	-	-	-	-	-	3	42	6	-	3	56

Gjatë periudhës 01.01.2025 – 30.04.2025 kemi patur këto situata :

- Pyje, shkurre, kullota 160 .
- Situata zjarri në banesa 11.
- Viktima 0 .
- Ndërhyrje shpëtimi dhe emergjence 47.
- Ndërhyrje djegie makinash 13 .
- Situata zjarri të ndryshme objekte shërbimi, dyqane, salla, magazina 0.
- Nuk ka qenë e nevojshme ndërhyrja 13.

Ndërhyrja e menjëhershme e efektivave tanë nën drejtimin e komandantëve të cilët e kanë vlerësuar cdo njoftim në kohë si dhe institucioneve mbështetëse si Policia e Shtetit për zjarrvëniet e qëllimshme ka bërë të mundur frenimin e zjarreve dhe kallëzim penal për zjarrvënësit.

Nga Sektori i Parandalimit gjatë periudhës 01.01.2025 – 30.04.2025, janë hartuar planet e punës mujore ku janë ushtruar kontrolle dhe janë marrë masa ndëshkuese me gjobë aty ku janë konstatuar shkelje. Tabelat përmbledhëse të sektorit të Inspektim-Parandalimit si më poshtë :

MASAT									
	Konstatime me procesverbal (dënim me gjobë)	Gjopa me vendim	Bllokime	Kallëzim penal	Akte ekspertize (për zjarret e rëna)	Akte teknike (Çertifikatë e mbrojtjes nga zjarri)	Ripërtëritje akte teknike (Çertifikatë e mbrojtjes nga zjarri)	Vërtetime zjarri	Miratim projekti për PMNZSH
ANAR	-	-	-	-	9	8	1	-	8
SHKURT	-	-	-	-	1	8	1	2	13

MARS	-	-	-	-	-	4	-	-	5
PRILL	-	-	-	-	-	11	2	-	17

INSPEKTIVE

	Objekte, aktivitetet Civile (bani mi)	Objekte, aktivitetet shërbimi (dyqane, salla, magazina, etj.)	Objekte, aktivitetet e akomodues turistike	Objekte e aktivitetit Didaktike (shkolla, kopshte, çerdhe)	Objekte ku ushtohet aktiviteti tregëtimi me lëndë lehtësisht të djegshme	Objekte, aktivitetet artizanale	Objekte historike, artistike të destinuar (muze, galeri, ekspozita)	Objekte të destinuar për impjante sportive	Depozita gazi të fiksuara me kapacitet deri në 5m³	Depozita gazi të fiksuara me kapacitet mbi 5m³	Impjante për shpërndarje të karburantëve	Objekte administrative
JANAR	-	9	8	-	6	-	-	-	-	2	3	-
SHKURT	1	14	5	-	4	-	-	-	-	-	5	-
MARS	1	9	6	2	4	-	-	1	-	1	5	-
PRILL	-	4	8	-	8	-	-	-	-	-	5	-

Akte teknike, certifikatë e mbrojtjes nga zjarri 31.

Vërtetime zjarri 2.

Ripërtëritje akte teknike të mbrojtjes nga zjarri 4.

Miratime të projektit të MZSH-së 43.

Akte ekspertimi për zjarret e rëna 10.

Vëmendje e veçantë i është treguar plotësimit të evidencave, statistikave dhe dokumentacionit ligjor. Shefi i Sektorit të Ndërhijjes ka marrë masat e duhura për rritjen, forcimin e shkallës së gatishmërisë, rritjen tekniko-profesionale të efektivit dhe ka eliminuar çdo rast problematik.

Gatishmëria e mjeteve, paisjeve dhe mjetet zjarrfikëse kontrollohen për gatishmërinë e tyre për të gjithë kompletimin me paisje mbështetëse, kompletimet me materiale të përcaktuara në mënyrë taksative nga Ligji, Udhëzimet, VKM, Rregulloret e miratuara. Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimeve të Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, Urdhërat dhe Vendimet e Kryetarit të Bashkisë Vlorë këtë periudhë janë zbatuar me korrektësi.

Gjatë periudhës në vazhdim kemi për detyrë si më poshtë :

- Mbajtja në gatishmëri të përhershme e automjeteve zjarrfikës, materialeve mbështetëse dhe ato ndihmëse që përdoren nga shërbimi ynë.

- Gatishmëria e efektivit zjarrfikës në çdo kohë dhe rrethanë për t'ju përgjigjur situatave të paparashikuara.
- Dhënia në kohë e informacionit të situatave reale të ndodhura në territorin e Bashkisë, dhe në raste nevojë në ndihmë të bashkive fqinje.
- Shefi i Sektorit të ndërhyrjes të zhvillojë analiza të veçanta për ngjarjet e rënda të ndodhura në territorin e bashkisë dhe të jetë e specifikuar situata reale me të gjitha elementet përcaktuar sipas VKM nr.520 datë.25.07.2019.
- Të ndiqet në vazhdimësi gatishmëria e efektivit dhe kontrolli fizik i Stacioni të MZSH-së, Bashkia Vlorë.
- Shefat e dy Sektorëve respektivë të ushtrojnë kontrolle të vazhdueshme gjatë periudhës së verës sipas detyrës së tyre funksionale dhe të marrin masa për vartësit e tyre.

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

I-SEKTORI I STREHIMIT

Gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2025 nga sektori që mbulon çështjet e strehimit janë kryer të gjitha procedurat e përcaktuara për strehimin social në aktet ligjore në fuqi dhe në rregulloren e brendshme të bashkisë, mbi funksionet, përgjegjësitë dhe kompetencat e këtij sektori. Konkretisht,

- 1.Kemi evidentuar banesat, të cilat në bazë të kërkesave të qytetareve janë përfshirë në projektet e “Përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”. Në bazë të urdhërit të Kryetarit të Bashkisë kemi dalë në cdo banesë, kemi informuar qytetarët për dokumentacionin e përcaktuar në aktet ligjore dhe kushtet e kriteret e përfitimit nga këto projekte.
2. Është përgatitur project-vendimi për “Miratimin e listës emërore të familjeve dhe individëve, që përfitojnë nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”, duke kryer të gjitha veprimet në terren dhe plotësuar dokumentacionin e përcaktuar sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe Termat e Referencës të ME, K&I.
3. Është hartuar projekti teknik, dosja me dokumentacionin e plotë të aplikimit dhe janë paraqitur pranë ME,K&I në afatin e përcaktuar.
- 4.Është përgatitur projectvendimi për të miratuar në Këshillin e Bashkisë “Për miratimin e deklaratës për bashkëfinancim drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për “Programin e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe ta pafavorizuara”
- 5.Është përgatitur project-vendimi për tu paraqitur për miratim në Këshillin e Bashkisë, “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit për çdo rast”, 34 familjet e para për vitin 2025, ku për hartimin e project-vendimit është plotësuar dhe shqyrtuar dokumentacioni i familjeve, verifikimi faktik në terren, është kaluar në komisionin e strehimit të bashkisë etj.
- 6.Është përgatitur project-vendimi për tu paraqitur në Këshillin e Bashkisë “Për miratimin e privatizimit dhe të vlerës së privatizimit të banesave shtetërore të paprivatizuara”.
7. Është përgatitur projektvendimi për tu paraqitur për miratim në Këshillin e Bashkisë “Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e prekura nga projektet e rikonstruksionit të rrugës Transballkanike.

8.Në bashkëpunim me rajonet dhe njësitë administrative bëjmë verifikimin në terren për të gjitha kërkesat e qytetarëve në lidhje me programet dhe projektet e strehimit

9.Çdo ditë është bërë pritja e qytetarëve për kërkesë-ankesat e ndryshme, kthim përgjigje kërkesave me shkrim, komunikimi shkresor dhe verbal me institucionet për problematika të ndryshme të strehimit, etj.

II - SEKTORI I TRANSPORTIT

Sektori i transportit zbaton me përpikmeri të gjitha dispozitat për nxjerrjen e liçencave dhe çertifikatave për transport rrethqytetes , qytetës ,taksi ,agjensi transporti dhe liçencë tregtim karburanti.

Licensimi i subjekteve bëhet në bazë të Ligjit 8308 datë 18.08.1998 "Për transportet rrugore" , i ndryshuar, VKM dhe udhëzimeve të MIE.

Gjatë 4- muorit të vitit 2025 është bërë licensimi i të gjithë atyre subjekteve të cilët kanë paraqitur kërkesat për licensim.

1-Taksi 4+1 janë licensuar gjithsej 18 subjekte, nga këto 2 subjekte me afat 2 vjeçar dhe 16 subjekte me afat 5-vjeçar.

2-Çertifikata për transport mallrash për llogari të vet janë 50 subjekte, për transport mallrash për të tretë janë 19 subjekte.

3-Çertifikata mjetesh rrethqytetase 36 subjekte.

4-Çertifikatë udhëtarësh për llogari të vet janë 5 subjekte.

5- Drejtoria DIIP pajis me liçence tregtim karburanti subjektet të cilat tregtojnë karburant. Në Bashkinë Vlorë në vitin 2025 ushtrojnë aktivitetin tregtim karburanti 40s subjekte, të cilat janë të pajisura me liçencë.. Për subjektet të cilat u ka mbaruar afati i licensimit DIIP ka bërë njoftime përkatëse të gjithë subjekteve që të paraqiten për të paguar taksen e licensimit për tregti karburanti.

7-Shërbimi i transportit urban në qytet kryhet nga subjekti "Urban Trans Vlora". Në këtë shërbim i është kushtuar vëmendje e veçante rritjes së cilësisë së transportit urban duke u shërbyer sa më mirë komunitetit.

8-Taksa e parkimit është vjelë nga të gjithë subjektet në momentin që subjekti pajiset me lic+certif, dhe vlefë e taksës parkimit bëhet në bazë të VKB .

Të gjithë subjektet të cilat kërkojnë parkim para subjekteve të tyre paguajnë taksën e parkimit me pagesë, në bazë të një kontrate të lidhur me Bashkinë Vlorë me nje afat një vjeçar dhe pagesa sipas VkB, për 4-mujorin e vitit 2025 janë lidhur kontrata me 43 subjekte.

Për të bërë të mundur rritjen e të ardhurave nga transporti, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike ka bashkëpunuar me Drejtorinë Tatim Taksave, dhe Policinë Bashkiake, po megjithatë këtu ka vend për përmiresime që këto kontrole të jenë më të shpeshta.

Sektori i transportit ka një koorespondencë të mirë me institucionet përkatëse si me DRSHTRR Vlorë, MIE dhe institucione të tjera.

Puna në lidhje me qytetaret pathuajse ka qënë e mirë, është gjetur një bashkepunim i mire me ta, duke mos patur probleme në këtë drejtim dhe duke bërë të mundur zgjidhjen e problemeve të tyre.

III- SEKTORI I INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Sektori i Infrastrukturës dhe Investimeve Publike përfshin dy sektor, atë të Infrastrukturës dhe Investimeve. Gjatë periudhës 4 Mujore Janar -Prill 2025 janë zbatuar projektet, sipas Projekt-buxhetit të Bashkisë 2024.

A. Janë kontrolluar dhe është mbajtur korrespondenca me kontraktorët dhe supervizorët për objektet që janë në faze punimesh konkretisht: Konkretisht janë hartuar dokumentacionet për objektet si më poshtë:

1. Rikonstruksion i rrugës së fshatit Radhimë
2. Rikonstruksion i rrugës së fshatit Drithas
3. Rikonstrukion i rrugës Petro Marko
4. Rikonstrukion i rrugës Gani Bejkosala
5. Rikonstrukion i rrugës Ded Gjon Luli
6. Rikonstrukion i banesave të shtresave në nevojë
7. Rikonstruksion i shkollës “Hasan Pulo”, “ Jani Minga”, tualeteve të shkollave “ Ismail Qemali”, “ 15 Tetori” dhe kopshtit 5, kopshtit Nr.14.
8. Rikonstruksion i kopshtit Nr.10
9. Blloku i banesave në lagjen “ Partizani”
10. Rikonstruksion i rrugëve të fshatrave ; Rruga e varrezave në fshatin Cerkovinë, “ Petro Llambro” Skrofotinë, rruga e shkollës në fshatin Babicë e Madhe.
11. Rikonstrksion I rrugëve, “ Rruga pas Bashkisë”, “ Donika Kastrioti”, “Meno Gjoleka”, “ Harun Panaja”, “ Malo Beqari”, “ Përballë shkollës Naim Frashëri”, “ Shtjefen Gjeçovi”, “ Haxhi Xhyheri” dhe “ Rrjeti rrugor pranë Komisarariatit të Policisë”
12. Zyrë informacioni me një ndalesë “ ONE STOP SHOP
13. Rikonstrukion i rrugës Ish Fabrika e Çimentos
14. Barriera metalike mbrojtëse për këmbësorët përgjatë rrugës “ Transbalkanike dhe Ali Demi”
15. Rrugët tek ish Pusi i Mezinis (rrugët Myslym Gjoleka, Ahmet Lepenica, Hysni Muka” në lagjen “ Kushtimi “ Vlorë.
16. Shtesë për pallatin 1300
17. Rikualifikim i hapësirave të gjelbërta të qytetit.
18. Rikonstruksion i rrugës së 7 (shtatë) Pallateve.
19. Rikonstruksion i rrugëve “ Zonja Çurre”dhe “ Alem Mehmeti”, fshati Tragjas.
20. Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “ Lef Sallata”.

B. Janë kontrolluar dhe janë marrë në dorëzim sipas urdhërave të ngritur objektet.

1. Certifikatë e marrjes në dorëzim të përkohëshëm objekti: “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Drithas.

D. Është mbajtur korrespondenca me institucionet dhe popullin për problematika të ndryshme në lidhje me infrastrukturën dhe investimet.

E. Sektori i Infrastruktues dhe Investimeve ka ushtruar funksionet e veta dhe në zbatim të kontratave të lidhura ka dorëzuar sheshet e ndërtimit kontraktoreve si dhe po kontrollon në mënyrë periodike punimet në objektet me poshtë:

- 1-Dorëzim i sheshit për segmentin rrugor "Ded Gjon Luli"
- 2-Dorëzim i sheshit për segmentin rrugor "Gani Bejkosala"
- 3-Dorëzim sheshi për segmentin rrugor "Petro Marko"
- 4-Dorëzim i sheshit të rrugës Radhimë
- 5-Dorëzim i sheshit për investimin për përmirësimin e banevesave të shtresave në nevojë
- 7- Rikonstruksion i shkollës "Hasan Pulo", "Jani Minga", tualeteve të shkollave "Ismail Qemali", "15 Tetori" dhe kopshtit 5, kopshtit Nr.14.
- 8-Rikonstruksion dhe shtesë anësore 3 kate në shkollën 9-vjeçare "Lef Sallata".
- 9- Rikonstrukion i rrugës Ish Fabrika e Çimentos
- 10- Barriera metalike mbrojtëse për këmbësorët përgjatë rrugës "Transbalkanike dhe Ali Demi".
- 11- Shtesë për pallatin 1300

Gjatë kësaj periudhe është bërë verifikimi në terren, Janar-Prill për gjendjen e institucioneve arsimore të qytetit Vlorë dhe sipas problematikave të vecanta kemi qënë pjesë e grupit të punës për evidentimin e problematikave të ndryshme.

Gjatë kësaj periudhe, në zbatim të VKB, janë dhënë leje infrastrukturore OSSH dhe Ujësjiellës kanalizimeve sipas problematikave të ardhura në Bashkinë Vlorë.

Gjatë periudhës Janar-Prill 2025, janë kryer këto detyra nga ana e specialistit të infrastrukturës të Drejtorisë së Investimeve dhe Infrastrukturës Publike,

Bashkëpunim me Shoqërinë Rajonale të Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a.Vlorë për kryerjen e punimeve në infrastrukturë publike, rrugë, sheshe, trotuare, etj, asete të Bashkisë Vlorë.

Janë dhënë autorizime për kryerje punimesh operatorëve ekonomik, për pikë lidhje uji dhe pikë e shkarkimit, sipas objekteve të lejeve të ndërtimit, operatorëve, "Fate,, "Serxho,, "2G&Jkonstruksion ,, etj.

U janë dhënë autorizime për kryerje punimesh qytetarëve, kryesisht për pikë të furnizimit me ujë.

Pra, gjatë kësaj periudhe, në zbatim të VKB, janë dhënë leje infrastrukturore OSSH dhe Ujësjiellës kanalizimeve sipas problematikave të ardhura në Bashkinë Vlorë.

Është mbajtur korrespondenca me institucionet, Avokatin e Popullit, Prefektin e Qarkut, etj.

Bashkëpunim me drejtoritë e tjera, konkretisht me Drejtorinë e Aseteve dhe Pronave publike, jemi pjesë e grupeve të punës për inventarizimin e pronave të Bashkisë Vlorë, 8604. Është finalizuar me VKB, inventarizimi I pronave të arsimit parauniversitar.

Është mbajtur korrespondenca lidhur me investimet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, kryesisht për ankesa të banorëve të blloqeve të pallateve të rigjenerimit urban, etj.

Është verifikuar në vend çdo problematikë e objekteve të arsimit parauniversitar dhe janë hartuar raporte mbi gjendjen infrastrukturore, si shkolla 9-vjeçare Akërni, kopshti Skrofotinë, etj.

Është mbajtur korrespondenca me institucionet.

Jemi pjesë e grupeve të punës për inventarizimin e pronave të Bashkisë Vlorë.

IV-SEKTORI I DEKORIT

Një shërbim që i ofrohet qytetarëve është dhe shërbimi i dekorit , me kontratën me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së dekorit “, i cili është realizuar nëpërmjet firmës “ **Endri Karaboja**” e kontraktuar nga Bashkia me afat 1(një) vjeçar dhe fond 2 454 060 (dy milion e katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH,ose 2 944 872 (dy milion e nëntëqind e dyzetë e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë me TVSH.

Ky shërbim është ofruar për qytetin e Vlorës dhe Njësitë Administrative që janë në varësi të Bashkisë Vlorë.

Kompania “Endri Karaboja” e ka lidhur kontratën në datë 27.12.2024 e vlefshëme deri në 27.12.2025 .

Shërbimi është ofruar për të gjitha festat të cilat janë të parashikuara në kontratë dhe për çdo rast tjetër të kërkuar nga Kryetari i Bashkisë (në rastin e përvjetorit të lindjes dhe të vdekjes së Ismail Qemalit në dt.24.01.2025).

Shërbimi i dekorit për këtë kontratë është realizuar,duke paraqitur për çdo muaj situacionet mujore dhe relacionin për punën e kryer, të cilat janë mbajtur nga mbikqyrësi i shërbimit në prani dhe të administratorit të firmës kontraktore.

V-SEKTORI I NDRIÇIMIT

- Zëvendësim i ndriçuesve të dëmtuar tek ish Fabrika e Çimentos 20 copë.
- Zëvendësim i ndriçuesve të dëmtuar të rrugës kryesore Fshati Kaninë 70 copë.
- Zëvendësim i ndriçuesve të dëmtuar të rrugëve të lagjeve Fshati Kaninë 35 copë.
- Zëvendësim i ndriçuesve të dëmtuar me llampë inkadenshente Led Fshati Sherishtë 28 copë.
- Vendosje e ndriçuesëve dhe shtrirja e linjës të ndriçimit Fshati Oshtimë 20 copë.
- Vendosje e ndriçuesëve dhe shtrirja e linjës të ndriçimit Fshati Babicë e vogël 25 copë.
- Zëvendësim i ndriçuesve të dëmtuar të rrugëve të fshatit Alikokë dhe Babicë e madhe 25 copë.
- Zëvendësim i ndriçuesve të dëmtuar tek ish pyjorja 30 copë
- Zëvendësim i ndriçuesve të dëmtuar në fshatin Panaja 15 copë
- Vendosje e ndriçuesëve dhe shtrirja e linjës tek pallatet e Gorishtit në jalli të Nartës 12 copë.
- Zëvendësim i 50 ndriçuesve të dëmtuar në rrugën Pelivan Leskaj 50 copë.
- Riparim i ndriçuesve të dëmtuar në rrugën Veledin Kollozi 40 copë

Riparime të ndriçuesave 250 Watt-ësh, në qytetin e Vlorës, sipas raportimeve të qytetarëve, apo strukturave të Rajoneve 150 copë.

Në kuadër të Efijencës Energjitike, uljes së konsumit të energjisë elektrike, synimi ynë ka qënë vendosje e ndriçimit Led, me kosto më të lartë investimi fillestar, por me kosto mirëmbajtje dhe shfrytëzimi rreth 60% më të ulët se ndriçimi inkandeshent. Ky proces do të vazhdojë në rajone dhe njësi Administrative.

POLICIA BASHKIAKE

Në fushën e mjedisit

Policia Bashkiake është e angazhuar me shërbim 24 orë për evidentimin e zjarreve të qëllimshme, apo në riaktivizimin e tyre në pikën e grumbullimit të mbetjeve urbane , ku dihet vështirësia pasi sipërfaqja e pikës së grumbullimit të mbetjeve është e madhe dhe parrethuar. Pothuajse përditë, konstatohet aktivizimi i shumë vatrave të zjarrit, ku është punuar nga të gjitha strukturat për fikjen e tyre . Vëmendje të shtuar Policia Bashkiake ka pasur ndaj subjekteve apo individëve që hedhim mbetje jashtë koshave të mbetjeve urbane , duke u bërë një shqetësim i vazhdueshëm për komunitetin dhe shërbimet e pastrimit . Për këtë në zonat me prioritet turistik ku dhe rrisku i këtij fenomeni është më i lartë kontrolllet e shërbimeve të Policisë Bashkiake kanë qënë pothuajse përgjatë 24 orëve. Ndaj rasteve të konstatuar për subjekte dhe qytetarë të ndryshëm janë marrë 13 masa administrative. Kemi nderhyrë me drejtorinë e mjedisit për cdo ankese të ardhur apo problematik të konstatuar.

Hapësirat Publike

Prioritet i punës tonë ka është kontrolli i territorit të Bashkisë sidomos shfrytëzimi i hapësirave publike. Janë bërë kontrole të përditshme vetëm ose në bashkëpunim me Inspektorët e DAV , ku për shkeljet e konstatuara kemi marrë masa administrative përkatëse në 8 raste. Për subjektet që nuk përmbushin detyrimet ligjore për shfrytëzimin e hapësirave publike apo dhënia e tyre cënon lëvizjen e këmbësoreve apo krijojnë problematika të ndryshme i kemi drejtuar DAV për moslidhje kontrate. gjithashtu janë marrë 7 masa administrative për aktivitet të paligjshëm.

Lirimi hapësirave publike të zëna nga tregtarët ambulant, nga subjektet që operojnë në katet e para të pallateve apo ndërtesa në rrugët kryesore të qytetit dhe njësi administrative etj ka qënë një detyrë e përditshme dhe është ndërhyrë në mbi 160 raste.

Qarkullimi.

Monitorimi i trafikut në qytet, parkimet e gabuara kanë qënë prioritet i përditshëm i Policisë Bashkiake aktualisht janë marrë katër masa administrative për sigurinë rrugore sipas parashikimeve të VKB nr 80.dt.02.02.2021 , gjithashtu janë marrë 5122 masa për kundravajtje rrugore , janë arkëtuar 5105 masa në vlerën totale (përfshirë kamatë vonesën) 4310924 lek.

Menaxhimi i trafikut pranë shkollave ka qënë një detyrë e përditshme e Policisë Bashkiake deri në përfundimin e vitit shkollor .

Një problematikë e pazgjidhur ende është për mjetet që parkohen në rrugët e qytetit për qëllime biznesi (makina që shiten apo jepen me qira), problematikë që kohët e fundit është shtuar shumë . Kodi Rrugor i RSH nuk parashikon masa administrative për raste të tilla, VKB e trajton si zënie të hapësirës publike . Për lirimin e kësaj hapësire duhet që të kemi një shërbim karroatreci dhe një pikë bllokimi të sigurtë për këto mjete . Për këtë i jemi drejtuar Drejtorisë Juridike , Ndërrmarjes së Shërbimeve Publike, Drejtorisë Financës dhe Buxhetit që brenda ambjenteve të NSHP të krijohet një pikë bllokimi e siguar me rrethim dhe monitorim të vazhdueshëm (rreth 200 m/2), si dhe lidhja e një akt-marrveshje me një subjekt privat të licencuar që ofron shërbim karroatreci sipas nevojave të Policisë Bashkiake. Aktualisht, kjo çështje ende ska marrë zgjidhje .

Të ndryshme

Janë zgjidhur në kohë të gjitha ankesat e ardhura nga qytetarët , Policia e Shtetit si dhe Platforma e Bashkëqeverisjes në rreth 400 raste .

Eshtë ndërhyrë si strukturë apo në mbështetje të IMT, njësive administrative e rajoneve për parandalimin e ndërtimeve pa leje apo prishjen e tyre në 25 raste.

Eshtë mbuluar me shërbim Tregu në Novoselë cdo ditë të enjte .

Eshtë bërë sigurimi i mbarëvajtjes së aktiviteteve të ndryshme social kulturore që ka organizuar Bashkia Vlorë përgjatë kësaj periudhë në jo më pak se 150 raste sidomos të aktivitetet në kuadër të “ Giro D’Italia” .

Eshtë bërë siguria e aktiviteteve sportive që Klubi Sportiv “ FLAMURTARI ” dhe “ORIKU” kanë zhvilluar sipas kalendarit sportive të tyre.

Policia Bashkiake është angazhuar në krijimin e kushteve optimale për punën që kryejnë firmat zbatuese të projekteve të shumta që kryhen në qytet. Gjithashtu kemi bashkëpunuar cdo ditë me drejtoritë e Bashkisë UK , NSHP , DIP, sipas kërkesës së tyre duke ndërhyrë në largime mjeteve që bëhen pengesë për punime dhe bllokime segmentesh rrugore në vartësi të proceseve të punimeve.

RAJONI NR.1

Në vijim të shkresës me nr.prot 7136, datë 07.05.2025 me lëndë mbi analizën e punës për periudhën 01.01.2025-30.04.2025. Falë përkushtimit dhe vëmendjes të veçantë ndaj qytetarëve dhe problematikat e tyre drejtuar Rajonit apo Bashkisë Vlorë. Në kuadër të mirëqeverisjes vendore, ofrimit të shërbimeve, zhvillimit social, ekonomik, të komunitetit të Rajonit Nr.1. Për periudhën 01.01.2025-30.04.2025. jemi impenjuar që të zgjidhim ankesat/kërkesat e tyre duke verifikuar në terren , përcjellë institucioneve perkatëse, jashtë juridiksionit të Bashkisë dhe në bashkëpunim me drejtoritë qe Bashkia ka në varësi zgjidhjen e problemeve dhe shqetësimeve të qytetarëve.

Në total kanë qënë 120 ankesa

- 80 prej tyre kanë qënë verbale
- 30 ankesa me shkrim
- 10 anesa jashtë juridiksionit tonë.

Janë zgjidhur 90 ankesa dhe 10 prej tyre janë në trajtim. Ankesat/kërkesat kryesisht kanë qënë në fushën e pronës dhe kufijve të saj , urbanistikës, infrastrukturës, konfliktet mes banorëve për shkarkime ujrash, kanalizimesh , puseta, tubacione depozita uji ulluqe etj. Për ndërrmarjet përkatëse apo mes banorësh dhe ndjekja e problematikave deri në zgjidhjen e tyre.

Nga ana jonë janë lëshuar 100 copë dokumenta me vlerë ligjore vërtetime, leje banimi, struktura komunitare, etj. Që i ka në kompetencë rajoni, mbështetur mbi bazën e dokumentave të pakundërshtueshëm autentike të qytetarëve dhe verifikimin në vënd brenda afateve kohore. Koordinimin e punës me zyrën e Gjëndjes Civile për verifikimin e banorëve, lëshimin e vërtetimeve të banimit për dokument të kërkuara nga qytetarët. Në bashkëpunim me strukturat e tjera të Bashkisë, drejtoritë, sektorët kemi asistuar gjatë projekteve për zhvillimin urban, social, strehimin dhe infrastrukturën dhe zbatimin e tyre. Nga ana jonë është bërë monitorimi i pastrimit cdo ditë në terren i mbetjeve urbane, organike apo të ngurta e inerte në pikat e grumbullimit, duke e shoqëruar me fotot përkatëse dhe raportim javor/mujor dhe në rastet kur është dashur ndërhyrje emergjente është bërë në saj të bashkrendimit të punës.

Fshirja, larja, dhe mirëmbajtja e rrugëve ka qënë tjetër prioritet i joni dhe Bashkisë, shërbim i cili është kryer rregullisht por ka dhe nevojë për përmirësim. Mirëmbajtja e gjelbërimit dhe lulishteve është ndjekur nga ana jonë me vëmendje dhe në menyrë periodike është kryer nga sektorët përkatës. Në institucionet arsimore të Rajonit nga komunikimi me drejtoritë e kopshteve dhe shkollave dhe evidentimi në terren është përcjellë nevoja e tyre për ndërhyrje në rikonstrukcion klasash, dyer , tualete, tarraca dhe palestrat përkatëse .Në disa prej tyre janë bërë riparime dhe të tjerat janë në proces. Kemi ndjekur gjithashtu investimet qe janë bërë ne rajonin tone duke filluar që nga punimet për rehabilitimin e rrugëve dhe trotuareve përgjatë territorit të rajonit, si ato kryesore dhe dytësore po ashtu rehabilitimi zonës se ish Fabrika e Cimentos, në lagjen Hajro Cakërri, lagjes Partizani, lagjes 4 Heronjtë, lagjes 15 Tetori, etj. Koordinimi i punës me Policinë Bashkiake ka qënë i bashkërenduar ne lidhje me rehabilitimin e trafikut, lirimin e hapsirave publike në të gjithë rajonin sidomos në Qendrën Historike ,largimin dhe masat administrative përkatëse për shitësit e pa autorizuar përgjatë trotuareve, kthimin funksional të korsisë së emergjencës nga Bashkia deri tek Spitali Rajonal ,duke liruar parkimet abuzive dhe marrjen e masave administrative. Koordinimi i punës me IMT ka qënë i bashkërenduar në lidhje me verifikimin e disa ankesave dhe konstatimeve tona në disa subjekteve mbi lejet për tenda të montuara në tokë, ndërtime të pajisura me leje ose jo etj. Koordinimin e punës me shërbimin e Veterinarisë, pasi qënte endacakë jane rikthyer përsëri në qarkullim dhe duke risjellë nje rrezik për jetën e kalimtarëve dhe turistëve të shumtë pranë sheshit të flamurit dhe zonës historike, pas ankesave dhe konstatimit nga ana jonë, kemi kontaktuar me Veterinierët të cilët kanë ardhur por ankohen për probleme mungese logjistike dhe transporti dhe shumë mangësi qe ata shprehën. Kontakti i vazhdueshëm me 3 specialistat e policisë të zonës në lidhje me mbarëvajtjen e rendit dhe sigurisë dhe zgjidhjen e konflikteve në komunitetin e të gjithë rajonit. Pjesë e punës tonë kanë qënë dhe kontakti me qytetarët për të ditur nevojat e tyre emergjente në zonën ku banojnë dhe jetojnë , mjedisin apo banesat e tyre për të dëgjuar shqetësimet dhe problematikat, kujdes të vecantë për fëmijët, moshatarët, studentët, personat me nevoja të vecanta dhe trajtim me ndihmë ekonomike dhe përkrahje sociale. Tërheqja dhe dërgimi i korrespondencës në zyrën e protokoll/arkivës në Bashki, nga ku është bërë dhe shpallja e vendimeve, njoftimeve dhe kthimi i përgjigjeve sipas afateve. Gjithashtu janë bërë edhe dëgjesa publike nën kujdesin e Kryetarit te Bashkisë dhe bashkarisht kemi

bërë takime periodike me banorët mbi të gjitha spektret e lartëpërmendura. Me synimin e përmbushjes së qëllimit për mirëqeverisjen e qëndrueshme dhe rritjen e besimit të qytetareve tek administrata nga ana jonë prioritet intensifikimi i punës dhe ndërveprimit midis drejtorive, për të qenë sa më pranë komuniteti dhe realizimit të objektivave të Bashkisë Vlorë.

Një performancë me standarte me të larta do të bëhej nëse do të kishte rishikim të kompetencave të Administratorëve të rajoneve.

Hartimin e një rregulloreje të re të përditësuar sipas nevojave të një qyteti turistik si Vlorë në zgjerim dhe me standarte europiane, dhe zbatimin e saj nga të gjitha strukturat në varësi të Bashkisë.

Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve

Në përgjigje të shkresës juaj nr. 7136 prot. datë 07.05.01.2025 “Mbi analizën e punës për periudhën 01.01.2025 - 30.04.2025 ” ju dërgojmë informacionin si më poshtë vijon :

Ndërmarrja Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane gjatë periudhës janar – prill 2025 ka pasur në fokus :

- përgatitjen e komponentëve të Planit të Biznesit të MIM Vlorë për vënien në funksionim të impianteve dhe aktiviteteve rajonale;
- ndërtimin e strukturave në qendrën rajonale të menaxhimit të mbetjeve në Sherishtë;
- organizimin e marrjes në dorëzim të pajisjeve dhe mjeteve të reja në kuadër të programit *Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta në Vlorë, Shqipëri*;
- mirëmbajtjen preventive të infrastrukturës, pajisjeve dhe mjeteve të vendosura në Landfillin e Sherishtës;
- zhvillimin e kapaciteteve të stafit;
- rritjen e ndërgjegjësimit të publikut.

1. Raportimi financiar

Me Vendimin nr. 3 datë 17.01.2025 “ Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vlorë ,institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2025” për Ndërmarrjen Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane janë miratuar 39 punonjës.

Për të përmbushur funksionet e ndërmarrjes MIM Vlorë në administrim dhe për vend depozitimin sanitar aktualisht janë rekrutuar 19 punonjës për disa pozicione, në përputhje me aktivitetet e parashikuara në fazën e parë të funksionimit, duke paraprirë aktivitetet gjatë periudhës së vënies në punë, testimit, dorëzimit/marrjes dhe fillimit të operimeve në landfill.

Ndërmarrja Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane për periudhën janar – prill 2025 ka kryer transaksione financiare sipas tabelës së mëposhtme:

Grupi	Titulli	Kapitull	Llog. Ekon	Plan	Fakt	Mbetje
0	5100	1	600	5,400,000.00	5,319,308.00	80,692.00
0	5100	1	601	1,200,000.00	969,165.00	230,835.00
0	1710	1	651	0.00	0.00	0.00
0	1710	1	166	0.00	0.00	0.00
0	5100	5	600	1,000,000.00	860,139.00	139,861.00
0	5100	5	601	50,000.00	46,112.00	3,888.00
0	5100	5	602	4,700,000.00	3,439,608.00	1,260,392.00
0	1710	5	651	0.00	0.00	0.00
0	1710	5	166	0.00	0.00	0.00
0	5100	5	231	0.00	0.00	0.00
Shuma				12,350,000.00	10,634,332.00	1,715,668.00

2.Ecuria e punimeve në Qendrën Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë

Ndërtimi i landfillit sanitar ka përfunduar 95% të punimeve ndërtimore të ndara sipas loteve si më poshtë:

LOT 1

- Qeliza 1 – Kanë përfunduar punimet e dherave në të gjithë qelizën 1. Kanë përfunduar shtrimi i shtresave të izolimit në skarpat dhe bazamet, shtresat që përbëhen nga Geo Sintetic Clay, HDPE, dhe Gjeotekstil. Ka përfunduar shtrimi i tubove të gazit në të gjithë perimetrin e qelizës. Ka përfunduar puna për mbushjen me material drenazhi (50 cm zhavorr lumi i larë). Ka përfunduar mbushja e qelizës 1.1 dhe qelizës 1.2. Ka përfunduar shtrimi i tubove HDPE PN 16 DN 355 që shërbejnë për mbledhjen e leksivateve. Rrethimi i të gjithë objektit ka përfunduar.
- Qeliza 2 – Kanë përfunduar punimet e dherave në gjithë qelizën 2. Kanë përfunduar dhe shtrimi i shtresave të izolimit në skarpat dhe bazamet, shtresat që përbëhen nga Geo Sintetic

Clay, HDPE, dhe Gjeotekstil. Ka përfunduar shtrimi i tubove të gazit në të gjithë perimetrin e qelizës. Ka përfunduar puna për mbushjen me material drenazhi (50 cm zhavorr lumi i larë). Ka përfunduar shtrimi i tubove HDPE PN 16 DN 355 që shërbejnë për mbledhjen e leksivateve.

- Leachate storage pond (LTP) – Në datën 11/03/2025 u nënshkrua kontrata për përfundimin e punimeve të mbetura dhe mirëmbajtjen për një periudhë një vjeçare të impiantit të trajtimit të ujrave të ndotura (LTP). Kompania kontraktore njoftoi përfundimin e punimeve dhe vënien në funksion të impiantit (LTP) në fund të muajit prill 2025. Përfundimi dhe vënia në funksion e këtij impianti ishte domosdoshëri për fillimin e depozitimin e mbetjeve në Landfillin e Sherishtës.
- Ndërtesa e Administratës – Kanë përfunduar punimet e betonit, elektrike, anti zjarri, kanalizimet dhe muratura. Kanë përfunduar linjat e brendëshme hidraulike dhe elektrike. Ka përfunduar instalimi i sistemit kapot dhe grafiato, aktualisht mungon lysterja, dyert dhe dritaret e objektit. Ka përfunduar shtrimi i trotuarëve me pllaka përreth godinës së administratës.
- Ndërtesa e Oficinës (ëorkshop) - Kanë përfunduar punimet e betonit, elektrike, anti zjarri, kanalizimet dhe muratura. Kanë përfunduar linjat e brendëshme hidraulike dhe elektrike. Ka përfunduar instalimi i sistemit kapot, janë vendosur qepenat dhe aktualisht mungon vetëm grafiato, lysterja dhe dyert e dritaret e objektit.
- Ndërtesa e parkimit (Canopy Hangar) – Kanë përfunduar të gjitha punimet.
- Sheshi administratës dhe MRF – Kanë përfunduar të gjitha punimet e dherave. Kanë përfunduar shtrimi i linjave nëntokësore si elektrike, IT, sistemi i kamerave, ujësjellësi, sistemi kundra zjarrit, kanalizimet. Ka përfunduar testimi i linjave të ujësjellësit, sistemit kundra zjarrit dhe sistemit të vaditjes, dhe po punohet me testimin e linjave kanalizimeve. Ka përfunduar shtrimi i sheshit me asfalt.
- Rruga e aksesit – Kanë përfunduar të gjitha punimet e dherave dhe të strukturave mbajtëse (muret). Kanë përfunduar betonimet e kanaleve anësore dhe vendosja e shtyllave elektrike nga Sherishta deri në landfill. Ka përfunduar shtrimi i rrugës me asfalt.

LOT 2

- Ndërtesa MRF – Kanë përfunduar punimet e dherave dhe të betonit. Kanë përfunduar të gjitha punimet metalike. Ka përfunduar shtrimi i linjave elektrike, IT, kundra zjarrit, kanalizimeve etj. në brendësi të sheshit të MRF. Ka përfunduar shtrimi i sheshit me beton të armuar dhe rifiniturat përkatëse.
- Kanë ardhur dhe montuar në kantier në masën 95% makineritë e MRF.

LOT 3

- Pasi MIM Vlorë përgatiti dokumentacionin ligjor dhe financiar në lidhje me pagesën e detyrimeve doganore dhe detyrimeve të tjera financiare, për makineritë dhe pajisjet e

destinura për Bashkinë Vlorë, gjatë muajit janar 2025 u mundësua shlyerja e detyrimeve doganore dhe detyrimeve të tjera financiare të prapambetura dhe tashmë këto makineri dhe pajisje janë në impiant, në pritje të përfundimit nga Bashkia Vlorë të procedurave, për kalimin në administrim të ndërmarrjes.

- MIM Vlorë është duke përgatitur programet e riparimit dhe mirëmbajtjes për mjetet e sipër përmendura, bazuar në manualët teknikë furnizuar nga prodhuesit dhe do nisë aplikimin e tyre sapo mjetet të kalojnë në administrimin e ndërmarrjes.
- Në bashkëpunim me KfW dhe me Konsulentin teknik, është punuar për përgatitjen e projekteve për pjesën e mbetur të punimeve të ndërtimit, e cila i hap rrugë procedurave të prokurimit për realizimin e këtyre punimeve.

3. Fillimi i depozitimit të mbetjeve në Landfillin e Sherishtës

Pas konfirmimit zyrtar në datë 25.04.2025 nga ana e supervizorit *Dahlem Beratende Ingenieure GmbH & Co. Wasserwirtschaft KG* për plotësimin e kriterëve të përcaktuara në *Planin fillestar të përdorimit* përgatitur nga specialistët e tij, në datën 26.04.2025, në Landfillin e Sherishtës filloi depozitimi i mbetjeve urbane të Bashkisë Vlorë. Depozitimi i mbetjeve realizohet duke zbatuar rigorozisht kërkesat teknike të shfrytëzimit të impiantit dhe duke mbajtur evidenca të sakta për sasinë e mbetjeve, kategorite e mjeteve dhe informacione të tjera të nevojshme për t'u pasqyruar në regjistrin e mbetjeve, një dokument shumë i rëndësishëm në shumë aspekte.

Monitorimi i mbetjeve

MIM Vlorë ka përpiluar qasjen konceptuale të monitorimit të mbetjeve referuar kërkesave ligjore për monitorim dhe raportim (Ligji për Mbetjet, VKM-të, Rregulloret specifike). Cikli i monitorimit vlerëson performancën dhe ndikimin mjedisor.

Monitorimi i parametrave do të realizohet nga një program kompjuterik, i cili do të shërbejë edhe për planifikimin e burimeve të ndërmarrjes, për menaxhimin e të dhënave sasiore dhe financiare në sistem. Ka përfunduar vendosja, testimi dhe kalibrimi i peshores në landfill. Peshorja do të shërbejë për të matur sasinë e mbetjeve që gjenerohen nga rajoni Vlorë-Veri, sasinë e mbetjeve që riciklohen dhe sasinë e mbetjeve që depozitohen në landfill.

4. Riciklimi dhe kompostimi

Ndërmarrja MIM Vlorë është përfshirë në aktivitetet e planifikimit për skemën pilot të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve me kontenierë depo në rajonin nr. 3 të qytetit të Vlorës, të drejtura nga ekspertët e Konsulentit Institucional. Në fazën e parë të testimit është propozuar të instalohen 10 stacione me 3 kontenierë depo për lloje të ndryshme materialesh (kanaçe, shishe, kartona,

ambalazhe). MIM Vlorë ka ndërmarrë aktivitetet e para të ndërgjegjësimit mjedisor me disa shkolla në qytetin e Vlorës.

Në funksion të studimit të tregut për materialet e riciklueshme janë vendosur kontakte me disa kompani riciklimi në Tiranë për të parë interesin dhe potencialin për bashkëpunim kur të fillojë puna në impiantin e ndarjes së materialeve.

Ka përfunduar plani mbi pikat e vendosjes së kontenerëve për mbetjet e riciklueshme në Rajonin Numër 3. Kontenerët për mbetjet e riciklueshme kanë ardhur dhe po punohet për shpërndarjen e tyre në qytet.

5. *Mirëmbajtje e infrastrukturës , linjave dhe mjeteve teknologjike në landfill*

Mirëmbajtja preventive e cila zhvillohet në landfillin e Sherishtës është një proces i rëndësishëm për të siguruar që pajisjet dhe sistemet të funksionojnë në mënyrë optimale dhe të shmangen defektet e papritura. Kjo përfshin inspektime të rregullta, pastrime, lubrifikime.

Proceset e mirëmbajtjes në landfillin e Sherishtës kryhen në baza ditore dhe përfshijnë një spektër të gjerë aktivitetesh teknike. Këto aktivitete përfshijnë mirëmbajtjen dhe pastrimin e kanaleve të drenazhimit të ujit të shiut nga aluvionet e grumbulluara, si dhe kryerjen e ndërhyrjeve të nevojshme riparuese në zonat e dëmtuara. Gjithashtu, përfshihet pastrimi nga vegetacioni dhe mirëmbajtja dhe kontrolli i saraçineskave dhe komponentëve të tjerë të sistemit të largimit të ujërave sipërfaqësorë për tu siguruar që janë në gjendje funksionale optimale.

Mirëmbajtja e pajisjeve dhe mjeteve përfshin kontrole të rregullta për identifikimin e dëmtimeve, testimin dhe vendosjen në punë me parametra minimale operative, për të shmangur avaritë dhe për të siguruar gatishmërinë e tyre të vazhdueshme për qenë operationale në momentin e fillimit të aktivitetit në landfill.

Vëmendje e veçantë i kushtohet kontrollit dhe shërbimeve ndaj mjeteve teknologjike që ndërmarrja administron, gjendja teknike e të cilave për specifikat që kanë si mjete , kërkon monitorim të vazhdueshëm deri në vënien në punë me kapacitet të plotë sipas funksionit që kryejnë.

6. Masa paraprake për garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë për personelin e MIM

Përveç aktiviteve të mirëmbajtjes së infrastrukturës , mjeteve dhe linjave teknologjike , të sistemeve të ndryshme të instaluar në impiant, është punuar në drejtim të sigurimit të kushteve optimale të punës për personelin që do të punojë në impiant, për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, konform kërkesave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, Ligjit “ Për sigurinë dhe shëndetin në punë ” dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

Ne kemi tashmë, të përcaktuar një set të plotë të pajimeve të mbrojtjes personale, me karakteristika teknike rigoroze konform standarteve ndërkombetare ISO dhe EN dhe atij shqiptar SSH, i cili do t'i garantojë përdoruesve mbrojtje të shëndetit dhe siguri në punë.

Përveç kesaj kemi të konsultuar me specialiste të fushës dhe të përfunduar skemën e mbulimit me shërbimin 3D të infrastrukturës dhe objekteve në impiant, e cila do t'i garantojë personelit përveç kushteve të punës dhe një ambient të mbrojtur.

Gjatë kësaj periudhe MIM Vlora , ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm administrativ teknik dhe financiar për fillimin e procedurave të prokurimit , për furnizimin me materiale dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme të mirëmbajtjes për funksionimin normal të impiantit dhe mjeteve në dispozicion.

6. Rritja e ndërgjegjësimit dhe marrëdhëniet me publikun

Ndërgjegjësimi dhe ndryshimi i sjelljes në raport me mbetjet urbane, është një sfidë por dhe një mision që ka marrë përsipër Ndërmarrja Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Vlorë, nëpërmjet sensibilizimit të nxënësve të arsimit parauniversitar dhe fëmijëve të kopshteve të qytetit të Vlorës.

Gjatë periudhës janar – prill 2025 janë zhvilluar disa aktivitete ndërgjegjësuere në kopshtet e mëposhtme :

- Kopshti nr 3
- Kopshti nr 7
- Kopshti nr 8
- Kopshti nr 9
- Kopshti “4 Heronjtë”

Temat dhe informacionet të cilat janë trajtuar me nxënësit :

- Prezantimi i Ndërmarrjes Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve, qëllimi dhe objektivat e saj
- Informimi për zonat në të cilat do të vendosen koshat për ndarjen e mbetjeve të diferencuara
- Informimi i nxënësve mbi mënyrën e trajtimit të mbetjeve
- Shfaqja e materialeve edukative dhe informuese për ndarjen e mbetjeve në burim
- Shpërndarja e fletëpalosjeve me informacione mbi riciklimin
- Krijimin e materialeve të reja me produkte të riciklueshme

Fushatat sensibilizuese, aktivitetet dhe informacionet që i janë përcjellë audiencës për grumbullimin e veçantë të lëndëve të riciklueshme publikohen edhe në faqet e rrjeteve sociale instagram e facebook.

Do të vazhdojnë fushatat sensibilizuese nëpërmjet shpërndarjes të fletëpalosjeve tek banorët, bizneset, me objektivin për të krijuar gradualisht bindjen që Vlora duhet të jetë jo vetëm një qytet i

bukur turistik por edhe një qytet i pastër banorë e të cilit kujdesen dhe për mjedisin.

Shërbime publike vendore

ANALIZA 4 MUJORE E SEKTORIT TE RRUGE - TROTUARE

Sektori i mirëmbajtje rrugë, trotuareve, plazheve në zbatim të realizimit të detyrave si dhe të grafikëve ka ndërtuar punën me brigada si më poshtë:

I-Mirëmbajtje e rrugëve

Janë asfaltuar sipërfaqet të dëmtuara të rrugëve si më poshtë;

Rruga që lidhë fshatrat Novosel,Fitore,Poro 6500 m2

II-Sinjalistika horizontale

Janë bërë vijëzimet e këmbësorëve në rrugët si më poshtë:

Rruga “ Sazani” Kryqezimet tek Universiteti dhe hyrja te Porti.

Rruga “ Hasan Kushta “

Rruga “ Veledin Kollozi “

Rruga “ Riza Salati “

Rruga “ Hajredin Haxhiraj “

Rruga “Janaq Kilica “

Rruga “ Pelivan Leskaj”

Rruga “Murat Terbaci”

Rruga “Dhimiter Konomi”

Janë bërë vijëzimet e vendqëndrimeve të taksive sipas kërkesave të dërguara nga Bashkia si më poshtë:

Rruga “Gjergj Araniti”

Rruga “ Veledin Kollozi “

Rruga “ Anita Bitri “

Rruga “Ismail Qemali”

III-Sinjalistika Vertikale

Janë vendosur tabela të dëmtuara në rrugët si më poshtë:

Lungomare tabelat treguese dhe lajmëruese.

Ne rrugën “Sazani“

Ne rrugën “Gjergj Kastrioti “ (Transballkanike)

Ne rrugën “7 Nëntori “

Ne rrugën “Janaq Kilica “

Ne rrugën “Hasan Kushta “

Ne rrugën “Anita Bitri “

IV- Në territoret e blloqeve të banimit janë shtruar sipërfaqe me beton dhe pllaka

Pallati 575 në rrugën “Ali Demi” është shtruar një sipërfaqe 170 m² me beton,
është shtruar një sipërfaqe prej 90 m², me pllakë.

V- Mirëmbajtje trotuare (në proçes)

Në trotuarin pranë rrugës “Hajredin Haxhiu” sipërfaqe rreth 300 m² dhe rruga lidhese me trotuarin tjetër po vazhdojnë të mbyllen me pllaka dhe bordura.

Riparim i Trotuareve në rrugën “Murat Tërbaci”

Analizë vjetore për vitin 2024 për Sektorin e Pastrimit dhe DDD.

Spektori i shërbimit DDD realizon dezinfektimë dezinspektimë dhe deratizimë në mjedisë publike si: vendstrehimë, lulishtë, parqë, çerdhë, kopshtë, shkollë, si edhe në rastet kur ka ankësë nga këto institucione publike.

Në objektivat e këtij sektori kanë qënë trajtimet parandaluese dhe te kontrollit të transportuesve mekanikë (aktorë) dhe vektorëve të klasës së insekteve me rëndësi shëndetësore, duke qënë burim ndotje dhe kontaminimi për komunitetin.

Janë realizuar trajtime me efekt rezidual per adultët, si edhe trajtime higjienizuese në mjediset e kontaminuara pranë koshave. Aplikimi realizohet me anë të pompave me presion, në pjesët ku pushojnë insektet ne stadin adult në mënyrë periodike dhe duke alternuar preparatet dezinfektues.

Këto trajtime kanë përfshirë edhe katet e nëndheshme të pallateve. Vatrast e infeksionit, si bodrume e mcr, janë inspektuar fillimisht dhe më pas është kryer ndërhyrja me preparat për dezinfektimin e tyre. Inspektimet dhe dezinfektimet kryhen çdo ditë të javës në vatrast e evidentuara më parë dhe në rast konstatimi të reja, të cilat vijojnë të cituara si më poshtë :

Në Rajonin 1 është realizuar inspektim, dezinfektim dhe dezinfektim si më poshtë:

- Banesë pranë Shkollës 9 vjeçare "4 Heronjtë" .
- Higjienizim në kontenerët e mbeturinave në rrugën "Ali Demi"
- Inspektim dhe dezinfektim përgjatë Kanalit të Ujrave të Larta .
- Pranë Shkollës 9 vjeçare "28 Nëntori" është higjienizuar dhe dezinfektuar hapsira rreth koshave te mbeturinave.

Në Rajonin 2 është realizuar inspektim përgjatë kanalit të Siavit dhe është ndërhyrë për dezinfektim në hapsirat që janë evidentuar problematike.

- Zona e ish ndërmarrjes dhe oficinës "Perlat Rexhepi".
- Kontenerët në lagjien "Isa Boletini".
- Kontenerët në rrugën "Pelivan Leskaj".
- Kontenerët në rrugën "Zenel Murra".
- Kontenerët te kryqëzimi i rrugës "Aristill Kokoshi" dh rrugës "Naim Frasheri" pranë shkollës "Mustafa Qemal Atatürk".
- Trajtim me larvicide përgjatë rrugës "Çamëria" në kuneta.
- Kontenerët në rrugën "Shyqyri Ali Merka" pranë Qendrës së Zhvillimit PAK.
- Inspektim dhe dezinfektim përgjatë rrugës "Rrap Sherifi" dhe rrugës "Avdyl Frashëri"
- Klubi shumësportësh "Flamurtari".
- Trajtimi me adulticid piretroid në rastin e sëmundjes infektive e lëkurës, e shkaktuar nga "sarcoptes scabiei" pas komunikimit me DROShKSh – Vlorë në një familje.

Në Rajonin 3 janë dezinfektuar Mcr, banesa të braktisura e parkime të nëndheshme si më poshtë:

- Rruga "Lef Sallata" pranë shkollës "Naim Frashëri".
- Zona përreth Shkollës "Musa Çakërri" mcr të kontaminuara me ujë të ndotur
- Zona te Konadi, dezinfektim në vendgrumbullim mbeturinash pranë koshave
- Kontenerët në rrugën ".Hajredin Haxhiraj" pranë Shkollës së mesme "Ali Demi"
- në rrugën "Misto Mele"
- Kontenerët në rrugën "Hasan Kushta" te Albano Romina

- Kontenierët në rrugën "Gjergj Kastrioti"
- Kontenierët në rrugën "Kosova"
- Është realizuar procedura DDD në Qendrën Ekonomike

Në Rajonin 4 janë dezinfektuar ndërtesa me larvicid por edhe ambientet rreth pallateve me adulticid , të cilat janë:

- Ndërtesa rreth zonës së quajtur Kapino pallat me numër 1258
- Pallate rreth Postës së Çoles përkatësisht pallati me nr.1267, zona mbrapa Shkollës 9 vjeçare "Jani Minga" pallat nr.1286 me ujë të ndotur në bodrum.
- Pallate me bodrume pranë Shkollës "15 Tetori"
- Kontenierët përgjatë rrugës "Enver Jaho"
- Kontenierët përgjatë rrugës "Mis Durham"
- Rruga "Zaho Koka" te Shkolla "Jani Minga"

Në Rajonin 5 janë higjienizuar dhe dezinfektuar në pallate të ndërtuara para viteve 90 dhe kemi ndërhyrë për minimizimin e problematikës përkatësisht:

- Kontenierët në rrugën. "Demokracia"
- Kontenierët në rrugën "Janaq Kilica" te Shkolla "Halim Xhelo"
- Kontenierët në rrugën "Zigur Lelo"
- Kontenierët në rrugën "Dervish Hekali" ish Fusha e Aviacionit
- Inspektim dhe dezinfektim përgjatë rrugës "Dervish Hekali" dhe kanalit te Aviacionit që përshkon atë, deri te kryqëzimi me rrugën " Lef Sallata" pranë Ujësjiellës Kanalizime.

Procedura DDD ka vijuar në kopshte, çerdhe gjatë muajit janar, duke u bere me pas ripërsëritje trajtimi në muajt mars-prill. Ripërsëritje e procedurës DDD ka përfshirë dhe vijon edhe në shkollat 9 vjeçare dhe të mesme, në kuadër të profilaksisë për sëmundjet respiratore nga rinoviruset, viruset respiratorë sincicial, parainflencial, adenoviruset dhe koronaviruset.

Gjatë muajit prill është realizuar trajtim me larvicid në vatrat e evidentuara si mcr, vendstrehime, kate të nëndheshme. Ky proces do të vijoj përgjatë gjithë sezonit veror në mënyrë që të kemi një kufizim të bezdisjes nga insektet të familjes Culicidae dhe familjes

Ndërmarrja e Pastrimit

Ndërmarrja e Pastrimit në përbërjen e saj ka veprimtarinë për heqjen e mbetjeve urbane nga kontenierët me mjete teknologjike, skrep, kamion, kamioncina dopio kabinë për heqjen e inerteve , fshirjen e rrugëve dhe trotuarevë me autofshesë dhe fshesë me punëtor, larjen e rrugëve dhe kontenierëve, larjen e rrugëve me autobot, pastrimin dhe plugimin e plazhit. Gjatë periudhës Janar-Prill është punuar me 3 turne për pastrimin e qytetit. Puna është kryer me mjete teknologjike me kapacitet 20 m3, 10 m3, 6 m3 për pastrimin e mbetjeve urbane nga kontenierët.Gjithashtu është punuar edhe me kamioncina për pastrimin e mbetjeve jashtë kontenierëve si psh divanë,dërrasa,inerte etj. Në disa

pika të nxehta ku sasia e inerteve ka qenë shumë e madhe dhe e pamundur për tu hequr me punëtorë, pastrimi i tyre është bërë nga skrepi dhe kamioni. Në turnin e I kemi punuar me 7 makina teknologjike, 5 kamioncina për heqjen e mbetjeve inerte, 1 kamion dhe 1 skrep për pikat ku sasia e inerteve të depozituara ka qenë shumë e madhe dhe nuk mund të hiqej me punëtorë dhe kamioncinë. Në turnin e II kemi punuar me 1 makinë teknologjike dhe 2 kamioncina. Në turnin e III kemi punuar me 7 makina teknologjike, 2 autofshesa dhe 1 bot uji për larjen e rrugëve pasi larja e rrugëve është e rëndësishme për të patur një qytet sa më të pastër dhe të shëndetshëm, sidomos në këtë sezon vere, pasi nuk ka reshje shiu dhe numri i mjeteve dhe popullsisë është shumë i lartë. Aktualisht po kryejmë dhe shërbimin e pastrimit të mbetjeve urbane të Njesisë Administrative Orikum. Gjatë muajit mars dhe prill kemi bërë plugimin e plazheve dhe pastrimin e tyre. Mjetet e Pastrimit kanë dalë bazuar në planin e punës së mëposhtëm: • 5 kamioncina në 5 Rajone nga ora 7:30 deri në 14:00 • 7 makina teknologjike në 5 rajone nga ora 10:00 deri në 16:00 • 2 kamioncina nga ora 16:00 deri në 22:00

Mbi analizën 4-mujore të Sektorit të Varrezave për periudhën janar-prill 2025.

Ndërmarrja e Pastrimit në përbërjen e saj ka veprimtarinë për heqjen e mbetjeve urbane nga kontenierët me mjete teknologjike, skrep, kamion, kamioncina dopio kabinë për heqjen e inerteve , fshirjen e rrugëve dhe trotuarevë me autofshesë dhe fshesë me punëtor, larjen e rrugëve dhe kontenierëve, larjen e rrugëve me autobot, pastrimin dhe plugimin e plazhit

Gjatë periudhës Janar-Prill është punuar me 3 turne për pastrimin e qytetit. Puna është kryer me mjete teknologjike me kapacitet 20 m³, 10 m³, 6 m³ për pastrimin e mbetjeve urbane nga kontenierët. Gjithashtu është punuar edhe me kamioncina për pastrimin e mbetjeve jashtë kontenierëve si psh divanë, dërrasa, inerte etj. Në disa pika të nxehta ku sasia e inerteve ka qenë shumë e madhe dhe e pamundur për tu hequr me punëtorë, pastrimi i tyre është bërë nga skrepi dhe kamioni.

Në turnin e I kemi punuar me 7 makina teknologjike, 5 kamioncina për heqjen e mbetjeve inerte, 1 kamion dhe 1 skrep për pikat ku sasia e inerteve të depozituara ka qenë shumë e madhe dhe nuk mund të hiqej me punëtorë dhe kamioncinë.

Në turnin e II kemi punuar me 1 makinë teknologjike dhe 2 kamioncina.

Në turnin e III kemi punuar me 7 makina teknologjike, 2 autofshesa dhe 1 bot uji për larjen e rrugëve pasi larja e rrugëve është e rëndësishme për të patur një qytet sa më të pastër dhe të shëndetshëm, sidomos në këtë sezon vere, pasi nuk ka reshje shiu dhe numri i mjeteve dhe popullsisë është shumë i lartë. Aktualisht po kryejmë dhe shërbimin e pastrimit të mbetjeve urbane të Njesisë Administrative Orikum.

Gjatë muajit mars dhe prill kemi bërë plugimin e plazheve dhe pastrimin e tyre.

Mjetet e Pastrimit kanë dalë bazuar në planin e punës së mëposhtëm

- 5 kamioncina në 5 Rajone nga ora 7:30 deri në 14:00
- 7 makina teknologjike në 5 rajone nga ora 10:00 deri në 16:00
- 2 kamioncina nga ora 16:00 deri në 22:00
- 7 makina teknologjike nga ora 22:00 deri në 04:00
- 1 makinë teknologjike nga ora 15:00 deri në 21:00
- 1 makinë teknologjike 10m3 në Njësinë Administrative Orikum
- Skrep+kamion:Pikat më të nxehta janë ish SMT, Ujësjiellësi, Karafilajt, Kaminat, Stadiumi, Rruga e Pyjores, Fabrika e Tullave, Kalaja, Fusha e Druve, Fabrika e Cimentos etj.

Fshirja e rrugëve, trotuarëve dhe shesheve me punëtorë dhe autofshesë:

Është bërë fshirja e rrugëve, korsive të bicikletave dhe trotuareve me autofshesë të Lungomares, rrugës Dhimitër Konomi, rrugës Sazani, rrugës Gjergj Kastrioti, Bulevardi Ismail Qemali, rruga Ali Demi, rruga Sulejman Delvina, rruga Sadik Zotaj.

Fshirja e rrugëve, trotuareve dhe shesheve me fshesë me punëtorë është bërë sipas një grafiku të caktuar nga mbikqyrësat ku në përditshmërinë e tyre pastrohet tregu i madh, tregu i orizit, tregu i coles, Bulevardi Ismail Qemali, rruga Gjergj Arianiti, rruga Mis Durhan, rruga Zaho Koka, rruga Enver Jaho, rruga Hasan Kushta, rruga Dhimitër Konomi, Blloqet e banimit në qytet.

Që prej muajit prill mjetet teknologjike kanë depozituar mbetjet e tyre në landfillin e Sherishtës.

Drejtoria e Bujqësisë, Mbrotjtjes së Mjedisit, Veterinarisë, Pyjeve dhe Kullotave

Sektori Pyje - Kullota

Sipas ligjit:

- nr. 57/2020 “Për pyjet”, të ndryshuar

- nr. 49/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9693 datë 19/03/2007 “Për Fondin Kullosor” të ndryshuar dhe të VKM nr.684, dt. 2.9.2020 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.433, date 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të MTM”, strukturat përgjegjëse për pyjet e kullotat pranë bashkise janë organi administrativ i shërbimit pyjor dhe përgjigjen për:

- sigurimin e mbrojtjes dhe
- për qeverisjen e qëndrueshme të pyjeve e kullotave

Struktura përgjegjëse për pyjet e kullotat ka këto objektiva:

- qeverisjen tërësore të pyjeve dhe të tokave pyjore;
- ruajtjen e ekuilibrit biologjik në fondin pyjor vendor;
- përgatitjen e projekteve për investimet në pyje e kullota;
- drejtimin dhe mbikëqyrjen e punës për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e gërryerjeve, të rrëshqitjeve e të ortekëve brenda territorit të bashkisë;
- sigurimin e mbështetjes teknike nëpërmjet këshillimit të pronarëve privatë dhe të komunitetit;
- mirëmbajtjen dhe funksionimin e infra-strukturës në fondin pyjor bashkiak;

Objekti parë i punës tonë ka patur të bëjë me

- Mbikqyrjen dhe kontrollin e fondit pyjor dhe kullosor.

Synimi: Përmirësimi i mbikqyrjes dhe kontrollit për të ndaluar degradimin e metejshëm të ekosistemeve natyrore.

Kullotat - Venia nën kontroll dhe rregullimi i aktivitetit të kullotjes.

· Janë bërë kontrole mbi zbatueshmërinë e ligjit dhe akteve nënligjore të kullotave, mbi fermerët:

- Që ushtrojnë aktivitetin e tyre me bagëti në kullotat dimërore dhe verore dhe nuk paguajnë detyrimet tarifore.
- Që aktualisht “përmirësojnë kullotat” me anë të zjarrit.

· Janë bërë monitorime mbi mundësinë e nevojave për meremetim lerash dhe vepra të tjera hidrike, me synim të riaftësimin e kapacitetit ujëmbajtës të tyre për sigurimin e ujit të pijshëm për blegtorinë gjatë një sezoni kullosor dhe krijimin e “rezervave ujore” (hidranteve) në rastet e rënies së zjarreve.

Treguesit/ pritshmëritë - Mundësi përmirësimi dhe rehabilitimi.

· Puna jonë ka rezultuar në takime të realizuara me fermerët, që meren me mbarështrimin e blektorisë, për ato zona apo fshatra ku dhe tendenca e shmangies ndaj pagesës së

kullotës ka patur shfaqjet e saja, si në fshatin Dukat dhe Tragjas. Ai që kullotë duhet të paguaj.

Për këtë periudhë, të ardhurat nga aktiviteti kullotës janë 41.200 leke. Të ardhura kto nga kontratat e kullotave.

- Ka dal nevojja për meremetim e veprave ujëpirëse malore në kullotat, me synim të riaftësimit të kapacitetit ujëmbajtës të tyre për sigurimin e ujit të pijshëm për blegtorinë gjatë një sezoni kullosor prej 6 muajsh.

Ndërkohë në kuadër të shkresës së Ministrit të Ministrisë së Brëndshme, nr. 3754 prot dt. 13.07.2021 me lëndë: “Kujtesë mbi detyrimet ligjore..... për marrjen e masave parandaluese për zjarret e stinës në sipërfaqet pyjore dhe kullota“, nga ana e sektorit u rishikua edhe një herë përcaktimi i nevojave për ndërhyrje emergjente në kuadër të sigurimit të rezervave ujore. Në kuadër të kësaj shkrese, përcaktimi i veprave ujore për rehabilitim/ndërtim vëpër të re, u bë jo vetëm në funksion të gjëndjes aktuale të tyre, por edhe në kuadër të nevojës/rëndësis së habitatit.

Për sa më sipër sektori vendosi që shuma prej 2.700 000 lekë (nga të ardhurat e siguruar nga aktiviteti i kullotjes), caktuar nga Bashkia do të perdoret konkretisht në masivin pyjorë mbi fashtin Tragjas dhe kullotat dimërore mbi fshatin Rradhimë dhe Tragjas.

Janë përgatitur dy projekte për:

- Rehabilitimin e lerës Ali Maçit në ngastrën pyjore nr. 6 të ekonomisë Tragjas – Shengjergj
- Bërjen e një lere të re (çimentoje) në ngastrën nr. 48, EK Dukat-Tragjas-Shashicë

Pyjet - Të vihet nën kontroll aktiviteti i ndërhyrjeve ilegale në pyje (prerje, zenie fondi, ndërtime)

- Janë kryer kontrole rutinë në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore që janë aktualisht në fuqi, për pyjet.

- Kemi bashkëpunuar me Njësitë Administrative dhe kryesitë e fshatrave në nivel Bashkie.

Treguesit/pritshmeria - Kontroll i aktiviteteve ilegale.

- Mbrojtje më e mirë e formacioneve pyjore.

- Janë minimizuar aktivitetet pa leje, si prerje, zënie fondi, ndërtime pa leje e tjerë.

- Kemi realizuar dhe do realizojmë në vazhdimësi një pyll të pastër.

- Ka përfunduar Plani i Mbareshtimit për grup ngastrat pyjore 15.02.2022 – 15.02.2032, Për Ekonomine Pyjore ‘Kume Shashicë’ të Pylli i Sodës, si dhe pjesa tjetër e kësaj Ekonomie (Uje i Ftohtë), i cili do të pasqyroj gjëndjen aktuale të këtij pylli, masat silvo teknike, që me realizimin e tyre do të cojnë në përmirësimin e situatës fito sanitare të tij, si dhe parashikimin e objektivave të tjera menaxheriale, gjithmone brenda legjislacionit shqipëtar për pyjet dhe statusit që i ka dhënë plani i pergjdhshem vendor.

Nuk kemi patur ndërhyrje me prerje në fondin pyjorë.

Zjarret - Të vihet nën kontroll mbrojtja e pyjeve dhe kullotave nga zjarri, vecanërisht prej atyre të vëna me qëllim nga barinjët.

· Eshtë përgatitur një program masash parandalimi dhe përgjigjja ndaj situatave emergjente që mund të krijohen nga zjarret për vitin 2024.

· Janë bërë takime për sensibilizimin e komunitetit të zonës, kryesisht të komunitetit të blegtorëve, me qëllim rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të tyre, për të ndryshuar konceptin se zjarret përmirësojnë kullotat (të cilat janë në proces të papërfunduar).

· Në kuadër të mbrojtjes nga zjarri, është bërë studimi në pyllin e Sodës (në kuadër të planit të mbarshtrimit), mbi krijimin e korridoreve antizjarr. Ky studim do të konkretizohet me një projekt i cili do të paraqes në menyrë të detajuar krijimin e korridoreve antizjarr në pyllin e Sodës.

· Eshtë shpallur fituesi nga ankandi për pastrimin i pyllit të Sodës nga të gjithë drurët e thyer, rrëzuar apo shkukur nga era. Subjekti fitues Merilian Gjinaj ka arkëtuar shumën prej 462.000 lekë pranë Bashkisë Vlorë .

Treguesit/pritshmeria: Sa me pak raste të venies së zjarreve me "dashje".

· Ngritja e strukturave të posacme për fikjen e zjarreve në nivel Njesie Administrative dhe fshati.

· Caktimi i pikave të vrojtimit-sinjalizimit, të levizshme, për zjarret në pyje e kullota. U caktuan 6 pika vrojtimit sinjalizimi, të cilat mbulohen nga 5 punonjesit, që sektori ka në terren.

Pikat janë:

- Shata dhe Fushe Dukat, mbulohen nga inspektori zonës Dritan Binjakaj.
- Tragjas fshat/vjeter , mbulohen nga inspektori zonës Gaxho Baco.
- Shashicë, Mallangas Radhimë mbulohen nga inspektori zonës Batjar Canaj.
- Pylli Sodës mbulohet nga inspektori i zonës Adriatik Tafili.
- Beshisht-Trevllazër mbulohet nga inspektori i zonës Vladimir Ganaj.

· Sensibilizimi i komunitetit për mbrotje të pyjeve nga zjarri. Janë realizuar dy takime, në fshatrat Dukat, Tragjas, Radhimë dhe Kaninë. (Në bashkepunim me MNZSH (zjarrfiksjë Vlorë) dhe SPZ (inspektorët e policisë).

· Janë vendosur postera në pyllin e Sodës, Beshisht, Dukat, Tragjas. Kaninë dhe Radhimë për sensibilizimin e opinionit publik.

· Sinjalizimi i rënies së zjarrit dhe shkuarja në vendngjarje në momentet e para të rënies së tij, ul ndjeshëm rrezikshmerin e përhapjes.

Tabela e mëposhtme jep qartësisht situatën e zjarreve në pyje e kullota bashkiake për periudhën 1 Janar-30 Prill 2025.

· Rastet e zjarreve –1

- Pyje 1 raste
- Kullota 0 raste

· Sipërfaqia e pershkruar nga zjarret, 44 ha

- Në pyje 44 ha
- Në kullota 0 ha

· Pronësia

- Bashkiake 44 ha

- Pyje 44 ha

- Kullota 0 ha

- Private 0 ha

- Kullota 0 ha

· Dëmi ekonomik ----- lekë

· Material drusor i djegur, por i përdorshëm -- m3

Objektivi dyte ka të bëjë me

- Planin financiar

Treguesit/pritshmeria: Sigurimi i të ardhurave nga kullotat.

Në periudhën Janar - Qershor, ne realizojmë lidhjen e kontratave për kullotat verore dhe në vazhdim ato dimërore. Deri tani janë në proces 5 kontrata, që kanë të bëjnë me aktivitetin kullosor për sezonin 6 muor 2025. Shuma e të ardhurave në kullota për këtë 6 muor është 41.200 lekë.

Të ardhurat 4 mujore:

Nr Bashkia Aktiviteti Vlefte/lekë

1. Vlorë Kullotje 41.200
2. Vlorë Sipërfaqe ne përdorim 30.855
3. Vlorë Ankand- Lënde drusore 462.000

Shuma 534.055

Objektivi i trete:

- Struktura Përgjegjëse Pyje e Kullota Bashkiake

Në zbatim të shkresës të AKP e cila na ngarkon me detyrën e inspektimit dhe kontrollit bazuar ne ligjin 57/2020 Për Pyjet, jemi në pritje për inspektimet online pasi specialistët e kontrollit janë trajnuar.

Objektivi i katërt dhe i fundit

Lufta kundër bimeve narkotike

Struktura përgjegjëse pyje-kullota Bashkia Vlorë ,ka mare pjesë në takimet e realizuara nga Drejtoria Vendore e Policisë te Qarkut Vlorë, me Njesitë Administrative Orikum, Novosel, Llakatund dhe Qëndër. U është dhënë detyrë specialistëve të zonave të cilet po bashkpunojnë me inspektorët e policisë (SPZ) në kontrollin që ushtrohet në fondin pyjor-kullor. Specialistët tanë janë pjesë e grupeve të punës të policisë për kontrollin e bimeve narkotike në fondin pyjor-kullor.

Në takimet e organizuara me blegtoret në fshatrat Kanine,Radhime,Tragjas,Dukat ,krahës problemeve të tjera si: zjarret, kullotjet pa leje, prerjet pa leje është trajtuar dhe problemi i minimizimit të bimeve narkotike.

BORDI I KULLIMIT

Mbi përgatitjen e analizës 4-mujore Janar-Prill 2025 , bazuar nëLigjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore ”(i ndryshuar), Neni 8, Pika 2 ,neni 9,pika1,1,b; VKB nr 87, datë26.09.2024“Per disa ndryshime ne VKB nr.92 datë 24.11.2023 ”Për miratimin e numrit tëpunonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara 2014, i ndryshuar” po paraqesim analizën 4 mujore të punës ,Janar,Shkurt,Mars, Prill 2025 të sektorin e Bordit të Kullimit dhe Ujitjes si më poshtë:

Viti 2025 është vlerësuar me seriozitet dhe përkushtim për detyrat që kemi me objektiv kryesor të punës që janë pastrimet e kanaleve kulluese dhe ujitëse dhe hidrovorit i qytetit, sipas inventarit të transferuar sipas vkm 1108/2015.

Cdo fillim viti bëhet plani vjetor i cili bazohet tek kërkesat e njësive administrative Qender, Novosele, Llakatund, Orikum për pastrimet e kanaleve ujitëse dhe kulluese sipas sezoneve të tyre të ujitjes dhe kullimit.

Konkretisht gjate ketij 4 mujori janë realizuar këto pastrime :

Njesine Administrative Qender

1. Pastrim kanalesh kulluese Xhyherine gjatesia 2030 ml
2. Pastrim kanali kullues Babice gjatesia 500 ml
3. Pastrim kanali Panaja (Perroi Kerkove) gjatesia 950 ml
4. Pastrim kanali Nartë gjatësia 1350 ml

Njesine Administrative Novosele

1. Pastrim kanalesh kulluese Skrofotine gjatesia 1050 ml
2. Pastrim kanalesh Cerkovine gjatesia 800 ml
3. Pastrim kanalesh kulluese Shamogjin gjatesia 750 ml
4. Pastrim kanalesh kulluese Mifol gjatesia 400 ml

Njesine Administrative Llakatund

1. Pastrim Kanali kullues Risili gjatesia 2740 ml

2. Pastrim kanalesh ujitëse Ceprat , gjatësia 250 ml
3. Pastrim Kanali kullues Mekat gjatësia 450 ml
4. Pastrim Kanali kullues Grabian gjatësia 1100 ml

Qyteti Hidrovori

1. Pastrim Kanali kullues 2000 Qytet Hidrovor gjatësia 1600 ml
2. Pastrim Vaskat e thithjes ne hidrovor hyrese dhe dalese

Gatishmëria e Hidrovorit të qytetit

Gatishmëria e hidrovorit të qytetit është në nivele të ulëta si pasojë e 2 pompave me defekt .

Aktualisht po punohet me pompën Nr.3 dhe Nr4 , dhe jemi angazhuar për të riparuar 2 pompat e tjera .

Është përballuar me vështirësi rënia e reshjeve si dhe ujërat e përditëshme që dalin nga qyteti i Vlorës.

Është i nevojshëm investimi kapital për ndërhyrje në hidrovor për zvendësimin e pompave të dëmtuara rëndë apo të amortizuara, si dhe pjesëve përbërëse që bëjnë të mundur funksionimin normal të hidrovorit.

- Struktura

Përsa i përket strukturës së sektorit kërkesa jonë që ky sektor të marrë formën e plotë :

- 1- Mekanik mjetesh të rënda
- 2- Administratorë/punojës për sezonin e ujitjes
- 3- Punonjës shtesë specialist të fushës së bujqësisë

Rezervuaret

Në përgjithësi gjendja e rezervuarëve paraqitet e qëndrueshme, në 3 prej rezervuareve më problematike janë duke u kryer punime rehabilituese mirëmbajtje digash (Prokuruar, puna në vijim).


P. Sektori

Alpin Skëndaj

























SEKTORI I ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT

Adresa : Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al

Mbi analizën e punës për periudhën 01.01.2025-30.04.2025

Spektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit funksionon në bazë të Ligjit nr.69/2012 i ndryshuar, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr.139/2015 dt.17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", V.K.M. nr.666, dt 10.10.2019, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", VKM 511 dt. 27.07.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa të VKM 666", Udhëzimit nr. 26, dt 25.11.2019, "Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar", VKB-ës nr.97, dt 28.12.2020 "Plani i përmisimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë", Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", Ligjit nr.9863, dt 28.01.2008 "Për ushqimin", Udhëzimit, nr.22, dt 25.11.2010 "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor, Ligjit nr.74/2013, dt 14.02.2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9863, dt 28.1.2008 "Për ushqimin", të ndryshuar, Ligjit nr.79/2017 "Për Sportin" (i ndryshuar) me ligjin 105/2020 dt.29.07.2020, Ligji nr.79/2019 dt 04.11.2019 "Për Rininë".

-Bazuar në VKB-në nr.97, datë 28.12.2020 "Plani i përmirësimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë" janë kryer kontrole të paplanifikuara në kopshtet dhe çerdhet në territorin e Bashkisë Vlorë për zbatimin e orarit të punës, menaxhimin, kujdesin ndaj fëmijës.

- Staf për organizimin dhe mbarëvajtjen e evenimentit të "Giro d'Italia".

-Bazuar në Ligjin nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", Ligjin nr.9863, dt 28.1.2008 "Për ushqimin", Udhëzim, nr.22, dt 25.11.2010 "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor, Ligjin nr.74/2013, dt 14.02.2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9863, dt 28.01.2008 "Për ushqimin", të ndryshuar janë kryer ndryshime në dokumentacionin mbi të cilin bazohet procesi i monitorimit të kopshteve në Bashkinë Vlorë dhe Njësitë Administrative për zbatimin e kriterëve të ligjshmërisë në veprimtarinë e institucionit arsimor parashkollor, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

-Bazuar në Urdhërin e brendshëm nr 119 datë 26.04.2024 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit edukativ individual për fëmijët me aftësi të kufizuara", mbikqyr komisionin i cili ka përditësuar planin PEI për 45 fëmijë me aftësi të kufizuara në kopshtet e Bashkisë Vlorë, në bashkëpunim me mësueset mbështetëse (përditësimi çdo 3 muaj).

- Organizues në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore Vlorë-Himarë dhe finalizimi i veprimtarisë së festës së mësuesit. U nderuan 35 mësues me titullin "Mirënjohje e Qytetit".

-Është zhvilluar procesi i mbledhjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit të bonusit financiar të nxënësve ekselentë të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme që aplikojnë në Bashkinë Vlorë. Janë trajtuar për vitin shk. 2024-2025 me bonus financiar 141 nxënës në shkollat 9- vjeçare publike dhe 151 nxënës në shkollat e mesme të përgjithshme publike.

-Bazuar në Ligjin nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", VKB-ës nr.97, dt. 28.12.2020 "Plani i përmisimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë", ndiqet procesi i regjistrimit të vazhdueshëm në kopshte dhe çerdhe, si dhe adresimi i problematikave.

-Bazuar në Urdhërin e Brendshëm Nr.450, dt. 11.12.2023 "Për një ndryshim në Urdhërin nr.3 dt 07.01.2020 mbi ngritjen e komisionit për kolaudimin e mallrave ushqimorë, industriale dhe elektrike" është kryer kontroll ditor i ushqimit për çerdhet, kopshtet pranë magazinës së Qendrës Ekonomike.

-Pjesë e grupit “Për ngritjen të punës, për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit të tenderit Blerje- Ushqimore” në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.48, dt. 22.02.2024

- Kthim përgjigje institucioneve të ndryshme.

-Pjesëmarrje në trajnime dhe aktivitete të ndryshme që organizojnë drejtori të tjera të Bashkisë Vlorë.

-Trajnime dhe aktivitete për rritjen e kapaciteteve.

-Kryerjen e procesit të monitorimit në kopshtet e Bashkisë Vlorë VKB-ës nr.97, dt 28.12.2020 “Plani i përmirësimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë”

- Anëtar i Komisionit të inventarit fizik të shkollave të mesme dhe konviktit të shkollës Industriale në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.10 datë 17.01.2025 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata dhe inventarit në përdorim për vitin 2024”

-Anëtar i Komisionit të inventarit fizik të shkollave kopshteve në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.10 datë 17.01.2025 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata dhe inventarit në përdorim për vitin 2024”

-Pjesë e komisionit të ekspertizës në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.33 dt.30.01.2025 “Për ngritjen e komisionit të ekspertizës”

- Grup pune në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.524 datë 05.12.2024 “Për kryerjen e procesit të inventarizimit të dokumenteve që administrohet nga zyrat në Bashkinë Vlorë”

- Grup pune në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.123 datë 16.04.2025 “Për gritjen e grupit të punës së vlerësimit të ofertave për shërbim komunikimi promovimi dhe diseminim në kuadër të Projektit ART4SEA”

- Grup pune në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.122 datë 16.04.2025 “Për gritjen e grupit të punës së vlerësimit të ofertave për shërbim organizim eveti në kuadër të ËRECKS4ALL”.

- Grup pune në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.127 datë 16.04.2025 “Për gritjen e grupit të punës së vlerësimit të ofertave për shërbim organizim ekspozite virtuale në kuadër të Projektit ART4SEA”

- Grup pune në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.106 datë 15.04.2025 “Për gritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike të ankandit “shitje me ankand të aksioneve të Klubit të futbollit ‘Oriku’ SHA në masën 100%”.

Grup pune në bashkëpunim EU4Youth për zbatimin e Hackathon për garancinë rinore.

SEKTORI I PROTOKOLL-ARKIVËS

Veprimtaria në Sektorin e Protokoll - Arkivës, bazohet në:

- Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.
- Vendimin Nr.4 datë 19.06.2017, të Këshillit të Lartë të Arkivave “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.
- "Norma tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Vendimet e Kryetarit dhe rregullores së Sektorit.
- Në protokoll cdo ditë janë kryer veprimet për pranimin, evidencimin, shpërndarjen dhe nisjen e korespondencës;
- Është kontrolluar zbatimi i kërkesave që duhet të përmbushë dokumenti;
- Janë hapur dosjet sipas pasqyrës emërtuese të celjes së tyre dhe vendosen e sistemohen në to dokumentat vazhdimisht;
- Është siguruar dorëzimi i plotë dhe në kohë i dokumenteve që krijohen dhe hyjnë në institucion;
- Janë plotësuar kërkesat për shfrytëzim operativ të dokumenteve nga drejtoritë e Bashkisë, duke bërë evidencimin e tyre;
- Pranimi i dokumenteve hyrës është bërë në Sektorin e Protokoll - Arkivës, cdo ditë nga punonjësit e zyrës së protokollit.
- Të gjithë dokumentet hyrës, cdo ditë pasi janë protokolluar, janë dorëzuar tek Nënkryetare e Bashkisë. Pasi kthehen dokumentet me nënshkrim, shënohen në kolonën përkatëse në regjistrin e korespondencës mod.1 dhe u shpërndahen drejtorive përkatëse kundrejt firmës, sipas librit të dorëzimit të dokumenteve nga sekretaria në sektorë dhe anasjelltas, Mod 4/1.
- Dokumentet e hyra në Bashkinë Vlorë, cdo ditë iu shpërndahen Drejtorëve.
- Dokumentet dalëse janë protokolluar cdo ditë dhe pas protokollimit, janë mbyllur dokumentet në zarfe, është plotësuar zarfi, dhe janë rregjistruar ato në librin e dorëzimit mod.4. më pas është kryer cdo ditë shërbimi postar.
- Për periudhën Janar – Prill, numri i protokollit në regjistrin e korespondencës ka arritur në 6802, pa përfshirë numrat e protokollit me fraksion.
- Cdo ditë janë nisur me shërbimin postar mesatarisht 200 zarfe.

Në Arkivë vazhdon puna për riorganizimin e haëpsirave për të krijuar kushtet për marrjen e dorëzimit të dokumentacionit të viteve të fundit nga drejtoritë e institucionit.

Gjatë 2 javëve në vazhdim është bërë verifikimi një për një dhe sistemimi i dosjeve RHK nëpër raftet sipas tematikës dhe viteve.

Kryhen mesatarisht 3 shërbime të brendshme (intrainstitucionale) dokumentacioni në ditë për drejtoritë.

Paralelisht kryhen verifikimet e nevojshme për trajtimin e shkresave të qytetarëve dhe institucioneve për kthim pergjigje, sipas rastit.

Vazhdon perpunimi i dosjeve të viteve 90' për përgatitjen për dorëzim në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Tirane. Është në proces përpunimi viti 1996.

Zyra e arkivës së Urbanistikës, pranë Bashkisë Vlorë, ka në administrim dokumentacion të llojit “Teknik” që janë prodhuar prej periudhës 1992-1999 nga ish- “Zyra E Urbanistikës”, pranë

institucionit të “Bashkisë Vlorë” dhe dokumentacion që është prodhuar prej periudhës 1999-2025 nga “Drejtoria e Urbanistikës”, pranë institucionit të “Bashkisë Vlorë”.

Tërësia e dokumentacionit të llojit “Teknik” dhe tipologji me origjinë “Zyrtare” që administrohet nga zyra e arkivës, është me përmbajtje si më poshtë vijon:

1- Dokumente në tekst

2- Dokumente grafike

3- Dokumente komplekse

Gjatë periudhës 06.01.2025 - 01.04.2025, zyra e arkivës teknike ka zbatuar detyrat sipas Ligjit “Për arkivat”, në ofrimin e shërbimit për shfrytëzimin e dokumentave, respektimin e kufizimit ligjor mbi mbrojtjen e të dhënave private të individit/subjekteve private dhe interesave të shtetit (edhe pse jam njohur me to për shkak të detyrës) si edhe njëkohësisht ka kryer me rigorozitet detyrat e mëposhtme:

1- Ka drejtuar punën dhe përgjigjen për administrimin e dokumenteve.

2- Ka verifikuar dosjet të cilave u ka mbaruar afati i ruajtjes.

3- Ka kryer përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve që administrohen në arkiv.

4- Ka shërbyer kopje të dokumenteve besnikërisht me origjinalin, pa komente dhe interpretime të interesuarve.

5- Ka kryer kontrollin periodik në mjediset e zyrës së arkivës (në raste dëmtime të dokumentit nga myku, insektet etj)

6- Ka marrë masa për ruajtjen e dokumenteve që administron, ku në mungesë të metodave për sigurimin e dokumentave sipas udhëzimeve të Drejtorisë Së Përgjithshme Të Arkivave, ka bërë të mundur sigurimin dhe ruajtjen e dokumentacionit nëpërmjet metodave tradicionale, me ajrosje natyrale, përdorimin e ngrohësve , pastrimin dhe dezinfektimin e kutive dhe raftëve etj.

Përgjatë periudhës 06.01.2025 – 01.04.2025, pranë zyrës së arkivës teknike janë përpunuar dhe shërbyer mbi **800** fletë dokumentacioni teknik.

Nga të cilat **60 %** e këtyre dokumenteve teknike të njehësuar me origjinalin u janë drejtuar institucioneve shtetërore dhe rreth **40%** janë shërbyer kundrejt personave të interesuar apo të autorizuar (pronarë trualli, shoqëri ndërtimi, individë që kanë bërë kontratë shit -blerje pasurie të paluajtshme etj).

Menaxhimi i Klubit Shumësportësh “Flamurtari”

Në përgjigje të kërkesës suaj me Nr. 7136 prot, datë 07.05.2025 për analizën e punës për periudhën 01.01.2025- 30.04.2025 po ju paraqesim si ka vijuar puna në Klubin Shumësportësh “Flamurtari”.

Gjatë periudhës 01.01.2025- 30.04.2025, kanë vazhduar aktivitetet zyrtare në Pallatin e Sportit Flamurtari dhe puna për përfaqsimin sa më të denjë të Klubit dhe Bashkisë Vlorë dhe për arritjen e objektivit të përbashkët të masivizimit të sporteve dhe përfshirjen e sa më shumë të rinjve në to.

- Ekipi Femrave në Basketboll të rritura ka fituar Kampionatin e Ligës Unike më 20 Mars 2025 dhe ka fituar Kampionatin Kombëtar Shqiptar më 25 Prill 2025.

- Ekipi i Basketbollit meshkuj të rritur në sezonin 2024-2025 përfaqëson klubin në Superligë ku sipas klasifikimit renditen në vendin e pestë.

- Ekipet zinxhir të basketbollit U18, U16 për femra dhe U18, U16 për meshkuj janë pjesë e Kampionatit Kombëtar për moshë.

- Ekipi Volejbollit Femra në kampionatin e sezonit 2024-2025 ka marrë vendin e tretë në Kampionatin Kombëtar dhe vendin e pestë në Kupën e Shqipërisë për Kategorinë e parë.

- Ekipi i Volejbollit femra U18 në sezoni 2024- 2025 ka nisur me përfaqësim të denjë për moshat U 18 dhe U 16, dhe kanë përfaqësuar skuadrën deri në gjysëmfinalet.

- Ekipi i Minifutbollit (Futsal) ka përfaqësuar deri në finale të kampionatit Kombëtar 2024-2025 duke marrë vendin e dytë.

- Ekipi i Kickbox ka arritur të mbrojë titullin kampion Bote, dhe pregatit sportistë të talentuar të cilët përfaqësojnë klubin në çdo kompeticion sportiv.

- Ekipi i Mundjes ka marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Federata Shqiptare e Mundjes për vitin 2025.

- Sportistët e ekipit të Boksit kanë përfaqësuar denjësisht klubin duke i sjellë titujt e vendit të parë për moshat dhe Kampionatit të Boksit për të rritur.

- Në disiplinën e atletikës kemi kampion Kombëtar në hedhje disku dhe 100 metërsh.

Gjithashtu dhe në peshëngritje kemi kampion kombëtar për moshat u18. Ekipi i qitjes falë punës së vazhdueshme ka marrë vende të para dhe të dyta në kampionatet e organizuara përgjatë vitit.

Ekipi i shahut, taekwondo, karate kanë marrë pjesë në aktivitetet zyrtare gjatë 4- muorit të vitit 2025 me rezultate të kënaqshme.

Projekti	Plani vjetor	Fakt 01.01.2025-30.04.2025
Ekipi basketbollit meshkuj te rritur	4,000,000	2,246,250
Ekipi basketboll meshkuj te rinje	500,000	272,250
Ekipi basketbollit femra te rritura	9,000,000	4,431,045
Ekipi basketbollit femra te reja	500,000	107,505
Ekipi I volejbollit femra te rritura	2,500,000	829,375
Ekipi I volejbollit femra te reja	400,000	136,985
Ekipi I boksit	4,000,000	1,186,875
Ekipi I ciklizmit	1,200,000	423,125
Ekipi I mundjes	1,400,000	363,750
Ekipi I Ping Pong	400,000	101,250
Ekipi I peshengritjes	800,000	228,750
Ekipi I karatese	400,000	71,250
Ekipi I minifutbollit	4,000,000	1,878,750
Ekipi I qitjes	1,200,000	412,500
Ekipi I taekwondo	400,000	155,625
Ekipi I bilardos	700,000	141,250
Ekipi I atletikes	300,000	71,250
Ekipi I shahut	500,000	129,375
Ekipi I kickbox	2,000,000	536,250
Ekipi futboll femra	300,000	71,250
Ekipi I notit	600,000	142,500
Ekipi I tenisit	300,000	71,250
Energji elektrike	600,000	136,728
Ujë	230,000	79,639
Telefoni+ Sherbim interneti	80,000	13,200
Shperblime per ekipe dhe individ kampion	1,500,000	21,000

Grumbullim te ekipeve per trofe	1,000,000	0
Federime+ Gjyqtari sportive	4,000,000	866,400
Shpenizme te paparashikuara	200,000	0
Shpenzime publiciteti	800,000	0
Udhetime dhe dieta personeli	400,000	17,903
Riparime te vogla+ shp. Te tjera	1,000,000	0
Materiale sportive	1,000,000	0
Sigurimi I lojtareve	600,000	0
231 Paisje teknike, tabela elektonike, Pc	3,000,000	0
Shpenzime bileta udhetimi transferim lojtaresh te huaj	1,000,000	174,990

1. Projekti : Teatrin “Petro Marko

Duke u nisur nga qëllimi kryesor i punës për Teatrin “Petro Marko”, pasurimin e jetës artistike e kulturore në qytetin e Vlorës, dhe referuar shkresës suaj nr.7136 prot, datë 07.05.2025 ju paraqesim aktivitetin e këtij Institucioni për periudhën 01 Janar 2025 - 30 Prill 2025 si më poshtë:

JANAR 2025

1. Shfaqja për fëmijë “Ëndërr apo e vërtetë”, regjia dhe teksti Dajana Nenaj, as/regjisor Denis Fiku, interpretojnë: Eno Basha, Rosela Isufi, Anxhelo Hysenaj me mbështetjen e Bashkisë Vlorë. Shfaqja pati shumë sukses dhe u duartrokit për dy ditë në Teatrin “Petro Marko”, në datat 18 dhe 19 Janar 2025.
2. Komedia “Gruaja e burrit tim” me regji të Kiço Londo dhe as/regjisor Olgert Mataj. Falë aktorëve të mrekullueshëm të zgjedhur me kujdes shfaqja pati shumë sukses dhe duartrokitje në Teatrin “Petro Marko”, për dy ditë 18-19 Janar 2025.

3. “Ekspozitë pikturë Ylli Meca” në hollin e Teatrit “Petro Marko”, në datat 22-23 Janar 2025 e cila u vizitua me mjaft interes nga artdashësit vlonjat.

SHKURT 2025

Histori e një dasme Arbëreshe “Arbëria thëret, Vlora përgjigjet”. Një shfaqje teatrale “VËJ KURORË”, nga aktorë të qytetit San Marzano di San Giuseppe, komuniteti më i madh Arbëresh në Itali. Shfaqja mbështetet nga Agjensia Italiane për bashkëpunim dhe zhvillim në Rajonin e Puglia’s nga Shoqata ‘Pro Loco Marciana di San Marzano u shoqërua me disa fotografi ku paraqitej ceremonia martesore tipike e rajonit , në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë dhe Teatrin “Petro Marko” në datë 22 shkurt 2025.

Mbrëmje poetike “C.V e Jetës” me protagonistë kryesor aktorët Eglja Ceno dhe Kundret Alikaj. Një shfaqje e ndërtuar mbi veprën e poetit të mirënjohur Petrit Ruka ku fjala e bukur dhe e zgjedhur dhe na bëri të mendojmë dhe gjykojmë më mirë për veten dhe për të tjerët , mbajtur për dy ditë 15-16 shkurt 2025.

MARS 2025

Koncert “Star Dance Academy”. Pati pjesëmarrje të shumtë gjithashtu u shoqërua me durtrokitje të shumta , i mbajtur në 9 Mars 2025.

Monodrama” Ëngjëjt” me regjizor: Odise Plaku ,Interpreton :Vefi Redhi, pati shumë emoncine të forta ,mbajtur për dy ditë 11 dhe 12 Mars 2025.

Komedia “Djemtë Vezulles” me autor Neil Simon dhe regji të Roland Minga ,shfaqur me shumë sukses në teatrin “Petro Marko”,në datat 21/22/23/28/29/30 Mars.

E luajtur nga trupa e aktorëve Artan Islami, Astrit Hasani, Alba Shtembari dhe Matilda Avduli.

Koncert “Pranvera”që pati shumë pjesëmarrje në sallën e teatrit “Petro Marko” organizuar në bashkëpunim me Shkollën Artistike “Naim Frasheri”,mbajtur 26 Mars 2025.

PRILL 2025

Orkestra Simfonike “OSFA ” në Teatrin “Petro Marko”, një koncert i vecantë që solli talentin, emocione të thella dhe shumë duartrokitje përmes muzikës klasike, në bashkëpunim artistik me Forcat e Armatosura , i mbajtur në 12 Prill 2025.

Koncerti nga Global Dance “Spring recital” pati pjesëmarrje të lartë gjithashtu u shoqërua me durtrokitje të shumta ,i mbajtur në 14 Prill 2025.

“Gurra Folk Fest ” i mbajtur në datë 18 Prill 2025. Festival folklorik me pjesëmarrjen e shkollave të mesme të Qarkut Vlorë, ku nxënësit përfaqsoan traditat dhe kulturën e zonës me performancë mbresëlënëse.. Ky festival pati pjesëmarrje të lartë dhe duartrokitje. Vendin e parë në këtë Festival e fitoi shkolla e mesme “Sulejman Delvina”

QENDRA E KULTURËS DHE ARTIT

Ky raport përmbledh aktivitetet kryesore të zhvilluara nga Qendra e Kulturës dhe Artit gjatë periudhës Janar – Prill 2025. Në përputhje me misionin për të ruajtur dhe promovuar trashëgiminë kulturore të qytetit të Vlorës, janë organizuar veprimtari të shumta edukative, artistike, historike dhe bashkëpunime ndërinstytucionale, me përfshirjen e gjerë të komunitetit, shkollave, universiteteve dhe institucioneve partnere kombëtare dhe ndërkombëtare.

◆ OBJEKTIVI & MISIONI

Qendra e Kulturës dhe Artit ka si synim kryesor:

- Ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.
- Zhvillimin e jetës artistike dhe edukative në komunitet.
- Inkurajimin e pjesëmarrjes aktive të të rinjve dhe qytetarëve në aktivitete kulturore dhe historike.

-
- ◆ Ne Pallatin e Kultures jan angazhuar 30 praktikantë të pranuar nga Qendra e Punësimit Profesional , qe kan ndihmuar ne rritjen e organizimit në evente kulturore, teknike dhe edukative. Gjithashtu kan ndikuar ne rritjen e prezences ne medial sociale.Rritje e ndjeshme e ndërveprimit me publikun përmes promovimit të aktiviteteve në rrjetet sociale. U mor pjesë ne festivalin e etnosit, "Hasi Jehon" ne Kosove me grupin polifonik dhe monofonik, ku vleresuam me çmim të parë .U organizuan evente për:
 - Dita e Poezisë
 - Dita e Pavarësisë së Kosovës

◆ FESTIVALI TEATROR I SHKOLLAVE TË MESME

Edicioni i Parë – Vlorë, Shkurt 2025

- U zhvillua në datat 3 – 12 Shkurt 2025, me pjesëmarrjen e 7 shkollave të mesme.
- Finalja u mbajt më 12 shkurt.

1 Programi i pjesëmarrjes:

Data Shkolla

3 Shkurt J. Minga

4 Shkurt M.K. Atatürk

5 Shkurt Elite

6 Shkurt Perla

7 Shkurt Ali Demi

10 Shkurt H. Xhelo

12 Shkurt Finalja

♦ TEATRI I KUKULLAVE – Vlorë

 Tur Pranveror (Mars – Prill 2025)

Data Shfaqja

15 Mars E bija e Hënës dhe e Diellit

22 Mars Princi Bretk

29 Mars Princesha mbi bizele

5 Prill Peshku i Artë

12 Prill Kësulkuqja

19 Prill E bija e Hënës dhe e Diellit

 Maj 2025

- Premierë: *Perla e dritës së detit*

♦ KINEMA

- U shfaqën filmat shqiptarë :
- “Pasaporta”
- “Luli e Goni Lemes”
- film dokumentar “Gjenerata e imazheve” të regjizorit austriak Johannes Gierlinger

♦ VEPRIMTARIA E MUZEVE

✦ Ekspozita & Përkujtime

- Ekspozitë për Qeverinë e Vlorës dhe firmëtarët – Janar
- Përvjetori i Brigadës së V – Sulmuese
- Kongresi i Lushnjës – Referime në shkolla
- 5 Maj – Dita e Dëshmorëve
- 18 Maj – Dita Ndërkombëtare e Muzeve
- 29 Maj – Udhëtim në Barcalla me studentët
- 5 Qershor – Ekspozitë fotografike për Luftën e Vlorës

♥ Bashkëpunime akademike

- Universiteti i Tiranës & Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë
- Zhvillim praktikash, guida historike dhe ekspozita
- Zhvillim i audioguide në gjuhën Latine për turistët

♦ BIBLIOTEKA PUBLIKE

- Këndi i Librit Ukrainas pranë sektorit të Librit Politik

♦ GALERIA E ARTEVE

- Në proces rikonstrukcioni përgjatë gjithë vitit

📍 KONKLUZION

Qendra e Kulturës dhe Artit – Vlorë ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbajtjen gjallë të kulturës qytetare dhe identitetit historik të Vlorës. Përmes aktiviteteve të vazhdueshme dhe bashkëpunimeve të shumta, kemi kontribuar në edukimin kulturor, integrimin e të rinjve dhe pasurimin e jetës artistike në qytet.

DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social në bashkinë e Vlorës ka në fokus tek shërbimet e kujdesit shoqëror nevojat sociale në rritje të kategorisë së grupeve në vështirësi ekonomike për të gjithë komunitetin, të jenë të mbuluara me shërbime ekzistuese dhe shërbime të reja sociale, për të qënë sa më pranë qytetarëve sipas modeleve dhe praktikave më të mira bashkëkohore.

Shërbimet ofrohen në përputhje me standartet dhe kornizën ligjore të shërbimeve sociale duke u bazuar në qasjen me individin, si prioritar në qendër të cdo shërbimi, duke ngritur një sistem të balancuar shërbimesh sociale të cilat do të kenë në fokus target grupet në nevojë, duke synuar një mbulim më të mirë të nevojave të tyre, një mbulim më të plotë me shërbime të tjera të kujdesit shoqëror, nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të shërbimeve ekzistuese dhe ndërtimit të shërbimeve të reja. Në vitin 2024 Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social ka aplikuar dhe ka fituar projektin e qendrës ditore për të moshuarit e cila do të fillojë të funksjonojë në vijim.

SEKTORI FINANCË-STATISTIKË

Numri i familjeve përfituesve në vështirësi ekonomike nga të ardhurat e bashkisë ka qënë afërsisht rreth 36 familje në muaj me një fond 4-mujor prej 517.500 lekë.

<i>Emërtimi</i>	<i>Përfitues të ndihmes ekonomike 4-mujor I 2025</i>	
	<i>Numër</i>	<i>Lekë</i>
Bashkia	24	317.500
Njesia Shushice	3	68.000
Njesia Qendër	3	48.000
Njesia Novosele	3	48.000
Njesia Orikum	3	36.000
TOTALI	36	517.500

Ndërsa për numrin e përfituesve të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike nga **fondi i kushtëzuar 6%** për 4-mujorin e parë të 2025 janë trajtuar 19 familje me një fond 240.315.

<i>Emërtimi</i>	<i>Përfitues të ndihmes ekonomike 4-mujori I 2025</i>	
	<i>Numër</i>	<i>Lekë</i>
Bashkia	19	240.315
TOTAL	19	240.315

Pagesat për të gjitha këto kategori e personave me aftësi të kufizuar kanë vazhduar pa ndërprerje edhe për personat që kanë mbaruar afatin e komisionimit për të mos krijuar probleme sociale dhe konkretisht:

Emërtimi	P.A.K + kujdestarë		Tetraplegjik+ kujdestarë		Verbëri kujdestari		Invalid		Total	
	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek
P.A.K 24	1932	91.078	571	54.473	677	44.559			3180	190.110

NJËSIA PËR ÇËSHTJET KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Nga Koordinatori Vendor i Dhunës në Familje për periudhën 4 mujore janar-prill 2025 janë trajtuar gjithësej 37 raste te reja ne formën e vendimeve te Gjykatës së Shkallës së Parë, përfshirë UMM-të dhe UM-të të paraqitura pranë Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social, bashki.

Këto raste dhune janë menaxhuar në bashkëpunim me Ekipin Teknik Ndërdisciplinar dhe në koordinim të përmirësuar mes aktoreve të këtij grupi, ku janë marrë edhe masat përkatëse për mbështetjen e plotë të viktimave.

Për periudhën janar-prill 2025 janë realizuar 2 mbledhje të Ekipi Teknik Ndërdisciplinor të dhunës në familje.

Rastet e paraqitura si me vendim gjykate ashtu edhe të vetëreferuara pranë Njesisë së Çështjeve Kundra Dhunës në Familje, jane menaxhuar në bashkëpunim me koordinatorin vendor dhe me antarët e Ekipit Teknik Ndërsektorial, duke u ofruar rasteve të dhunës, shërbime ligjore dhe psikologjike falas, shërbime këshillimi për burrat e dhunshëm.

Nga rastet e pajisura me UM janë trajtuar me ndihmë ekonomike ne masen 9900 lekë 30 raste duke kryer njëkohësisht monitorimet përkatëse në bashkëpunim me policinë vendore Vlorë, si dhe stafin e shërbimit Social, ndërmjetësim për punësim, informim dhe këshillim mbi te drejtat që ka një viktimë dhune në bazë të ligjit përkatës, si dhe ndërmjetësim për akomodim pranë strehëzave rezidenciale përkatëse. Gjatë periudhës Janar- Prill 2025 është ruajtur e njëjta mesatare mujore e rasteve të dhunës në familje ku ccdo rast dhune është trajtuar me përparësi, sipas nevojave të identifikuara me bashkëpunimin e ngushtë të të gjithë anëtarëve të MKR-së, si dhe janë monitoruar rastet me Urdhër Mbrojtje duke vlerësuar dhe adresuar nevojat e rastit. Gjatë periudhës Janar- Prill 2025 janë drejtuar në mënyrë të vazhdueshme UMM-të prej gjykatës pranë zyrës së Shërbimit Social. Çdo rast dhune i paraqitur pranë Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social ose çdo rast i referuar nga gjykata e rrethit gjyqesor Vlorë është kontaktuar dhe është bërë vlerësimi i nevojave nëpërmjet një intervistimi mes koordinatorit të dhunes, punonjësit social të vlerësimit të nevojave si dhe viktimës.

Pasi është vlerësuar nevoja e çdo rasti dhune, koordinatori ka informuar viktimën dhe e ka referuar në institucionet përkatëse.

Gjatë periudhës Janar- Prill 2025 janë referuar 20 raste dhune pranë Klinikës Ligjore “Vatra” dhe 10 raste për dhunuesit për këshillim psikosocial, ku viktimave të dhunës dhe personave ushtrues të dhunës, u është ofruar asistencë ligjore dhe psikologjike, zgjidhje martesore dhe kërkesepadi për UMM dhe UM si shërbime falas nga Klinika Ligjore e Qendrës Psiko-Sociale “Vatra”.

Duke bërë një analize të rasteve grupmosha më e prekur nga dhuna është fasha 26-35 vjec si dhe 36-45 vjec si raste dhune në familje.

Grupmosha më pak e prekur nga ky fenomen është fasha 19-25 vjeç.

Grate dhe vajzat janë target grupi më i marginalizuar nga fenomeni i dhunës. Statusi civil më i prekur nga fenomeni i dhunës në familje janë të martuar, më pas renditen kategoria e personave të divorcuar dhe më pak bashkëjetuesit.

Niveli arsimor i ulët ka qenë më i prekur prej fenomenit të dhunës në familje dhe më pas niveli arsimor i mesëm kurse niveli arsimor i lartë ka qenë më pak i prekur prej dhunës për vitin 2025. Një kategori e prekur nga fenomeni i dhunës në familje janë mosha e tretë, personat me AK si dhe komuniteti Rom dhe Egjiptjan, të cilët janë trajtuar me shërbime sociale nga Ekipi Teknik Ndërdisiplinor i Dhunës në Familje.

NJËSIA E MBROJTJES DHE TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Për periudhën Janar-Prill 2025, ka menaxhuar në total 82 raste dhe 15 janë raste të reja të fëmijëve në nevojë për mbrojtje sipas problematikave si vlerësime social-ekonomike të familjes për monitorim të rastit, për vendosje në kujdestari alternative, raste të fëmijëve në konflikt me ligjin. Janë asistuar të miturit në komisarjat në 2 raste me kërkesë të komisarjatit. Janë asistuar të miturit në prokurori në 4 raste. Ka qenë prezente në 50 seanca gjyqi me të mitur. Janë zhvilluar në total 30 vizita në banesë, 7 mbledhje të grupit teknik ndërsektorial si dhe 1 mbledhje SVK. Janë trajtuar 3 raste të dyshuar për abuzim seksual dhe përdorim të lëndëve narkotike. Janë bërë vlerësime në banesat e disa të miturve të cilët ndodhen në institucione për të parë mundësitë e tyre për rikthimin pranë familjes biologjike. Janë bërë vlerësime në familjen Hilaj dhe janë monitoruar të miturit kur janë kthyer për të kaluar pushimet në banesë. Janë mbyllur në total 2 raste. Vizitat në familje kanë pasur karakter kryesisht vlerësues mbi situatën sociale-ekonomike të familjes dhe janë kryer në varësi të problematikave të cilat kanë patur rastet.

Në muajin Shkurt është bërë lista e fëmijëve për kopështe dhe cerdhe për vitin 2025 ku me vendim të keshilli bashkiak janë përfshirë 20 fëmijë për frekuentim nga të ardhurat e fondit të bashkisë. Këta fëmijë janë pjesë e familjeve me probleme specifike socio-ekonomike, fëmijë të viktimave të dhunës në familje.

NËPUNËSI PËR ÇËSHTJET E BARAZISË GJINORE

Për periudhën Janar-Prill 2025, nëpunësi i barazisë gjinore ka asistuar në mbështetje me shërbim sociale si dhe asistim në vlerësimin e nevojave të rasteve sociale si dhe referim pranë institucioneve ofruese shërbimesh falas. Ka qene pjesëmarrës në të gjitha mbledhjet e këshillit bashkiak. Nëpunësi gjinor ka qene pjesëmarrës edhe në tryezat konsultative mbi çështjet e barazisë gjinore, si dhe pjesëmarrës në trajtime të ndryshme nga OJF-të me fokus barazinë dhe drejtësinë gjinore. Ka asistuar në seanca gjyqësore në bashkëpunim me Punonjësën e Mbrojtjes së Fëmijëve, për çështjet e fëmijëve me problematika socio-ekonomike si dhe ka asistuar në vlerësimet e nevojave të rasteve të dhunës në familje në bashkëpunim me Koordinatorën Vendore të Dhunës dhe ka qënë pjesëmarrës aktiv si në ETN ashtu dhe ne GTN e realizuara mbi çështjet e ndryshme dhe problematikat sociale të paraqitura pranë DNSHS-së.

NJËSIA E VLERËSIMIT DHE REFERIMIT TË NEVOJAVE TË RASTIT

Për periudhën janar-prill 2025 Njesia e Vlerësimit dhe Referimit të Rasteve ka zhvilluar një sërë aktiviteteve si:

Në bashkëpunim me koordinatorin vendor të dhunës në familje, njësia e vlerësimit ka realizuar 15 monitorime dhe vlerësime nevojash.

Në bashkëpunim me Punonjësën e Mbrojtjes së Fëmijëve për rastet e fëmijëve me problematika sociale si dhe monitorimet përkatëse, janë realizuar 10 vlerësime nevojash

Njësia e vlerësimit të nevojave në bashkëpunim me NJA-të si dhe Rajonet e qytetit të Vlorës kanë realizuar 40 vlerësime nevojash të familjeve të cilët janë përfitiues të sistemit Digjital të Ndihmës Ekonomike dhe përfitiuesve nga fondet e bashkisë. Specialisti i Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të nevojave ka qënë pjesëmarrës në 20 seanca gjyqësore për rastet e heqjes së kujdestarisë. Gjithashtu ka trajtuar 10 raste të reja të personave me problematika socio-ekonomike dhe të pastrehë.

Aktivitetet dhe shërbimet e ofruara nga Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen gjatë periudhës Janar-Prill 2025.

Shërbimet bazë	Shërbimet e detajuara
Numri i rasteve të trajtuara nga SHMFF	Në total janë trajtuar 24 raste të reja
Shërbime të kujdesit shoqëror si: monitorim i mirëqënies së qytetarit dhe lobim për realizimin e të drejtave të qytetarëve.	Takime me aktorë vendorë në lidhje me respektimin e të drejtave të qytetarëve dhe sigurimin e aksesit në rrjetin e shërbimeve në komunitet:

	të familjeve dhe menaxhimit të rasteve) Këshillime psikologjik; fëmijë (10 raste, 60 orë këshillimi) dhe të rritur (8 raste 50 orë). Janë asistuar nga psikologia rreth 16 raste fëmijësh dhe kryer vlerësime nga psikologia për të rritur rreth 19 raste gra të dhunuara. Mbështetje direkte(paketa ushqimore-0 pako, veshmbathje-higjeno-sanitare 0 pako). Në total familjeve u janë ofruar shërbime të integruara që kanë ndikur në mënyrë të drejtëpërdrejtë në rritjen e mirëqënies së fëmijëve e familjeve dhe parandalimin e institucionalizimit.
Shërbime të specializuara si kujdestaria në familje, psikoterapeutë, mësues special, logoped, fizioterapistë etje.	Shërbimi i kujdestarisë në familje me shërbimet e mëposhtme: - asistim gjatë takimit të fëmijës së vendosur në kujdestari alternative me nënë biologjike.(1 fëmijë) -Shoqërim në shkollë të fëmijëve (2 fëmijë) Shërbimi i Logopedisë: – kanë marrë shërbim logopedie falas 6 fëmijë. Shërbimi i fizioterapisë: – kanë marrë shërbim fizioterapie falas 3 fëmijë. Klasa pas shkolle: MUAJI JANAR: 2 fëmijë MUAJI SHKURT : 2 fëmijë MUAJI MARS : 2 fëmijë
Qendër burimore për dhënien e informacionit, ofrimin e trajnimeve, mentorim drejt plotësimit të nevojave dhe shërbime të specializuara.	Bazuar në hartën e shërbimeve sociale janë orientuar përfituesit drejt shërbimeve për të cilat kanë patur nevojë, duke iu dhënë informacionin dhe orientimin e duhur.

1. Qendra e zhvillimit P.A.K

Qendra e Zhvillimit për Personat me Aftësi të Kufizuar Vlorë si një institucion rezidencial i cili funksionon në përputhje me standartet dhe legjislacionin në fuqi për këtë target grup, edhe këtë vit ka organizuar aktivitetin e saj në përputhje me misionin dhe objektivat e vendosura.

Për 4-mujorin e parë për vitin 2025 pranë Qendrës së Zhvillimit PAK kanë marrë shërbim 29 rezidentë, 10 prej të cilëve janë në interesim nga familjari dhe pjesa tjetër, prej 20 rezidentësh janë të braktisur me vendim gjykate. Në organikën e saj Qendra ka një staf prej 40 punonjësish të ndarë në 2 sektorë: Sektori i Administratës dhe Sektori i Shërbimeve.

Aktualisht faktike janë 42 punonjes që japin shërbimin e tyre.

Misioni i kësaj qendre është zbatimi i politikave sociale me synim : Ofrimin e Shërbimeve cilësore, të qëndrueshme dhe në përputhje me standartet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Personat me Aftësi të Kufizuara duke qënë gjithnjë në koherencë me legjislacionin në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë së jetës, nxitjen e pavarësisë, përfshirjes dhe respektimit të dinjitetit të rezidentëve, si dhe integrimin e tyre në komunitet në mënyrë sa më të natyrshme, nëse kjo e fundit është e mundur.

Qendra e Zhvillimit për Persona me Aftësi të Kufizuara ka për Objektiv të:

- Rrisë cilësinë e shërbimit që ju ofrohet rezidentëve në drejtim të riaftësimit fizik dhe mendor të këtyre të fundit.
- Nxitjen dhe zbatimin e programeve aktive me qëllim krijimin e një procesi sa më natyral të integritetit të rezidentëve në komunitet.
- Krijimin i netëorkeve efektive me Institucione, Organizata Jofitimprurëse, Subjekte Juridike dhe Private të cilat promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e këtij target-grupi.
- Realizimin e Programeve edukativo-pedagogjike dhe riaftëtimit të personave me aftësi të kufizuara.

Detyrat :

- Ofrimi dhe krijimi i kushteve të favorshme dhe cilësisë për të jetuar dhe mësuar në bazë të programeve të riaftësimit.
- Përpilimi i programeve të edukimit dhe të integritetit në saj të bashkëpunimit të edukatoreve, specialistëve, monitorimi i të cilave bëhet nga Drejtoria.
- Zbatimi i legjislacionit dhe Standarteve.
- Hartimi i programeve për trajnimin dhe formimin e stafit.
- Administron dhe menaxhon buxhetin e caktuar.
- Raporton dhe informon Sh.S.SH dhe Bashkinë Vlorë mbi: statistikën dhe evidencat mujore, të ardhurat, transferimet e klientëve, raporte të realizimit të planeve mujore.
- Mban lidhje korrekte për çdo problem me Bashkinë Vlorë dhe SH.S.SH.

Si Institucion Shtetëror, social dhe rehabilitues pjesë e institucioneve të përkujdesit shoqëror në këtë Qendër ofrohen këto shërbime :

- Në nivel specialisti, të përfaqësuar nga punonjësi social, infermier, specialist logoped psikolog dhe fizioterapeut, edukatorët të cilat mbulojnë edhe nivelin edukativ-pedagogjik.
- Në nivel shërbimi, të përfaqësuar nga kuzhinieret, kujdestaret, sanitaret, mirëmbajtësi, magazinieri etj.

Deinstitucionalizimi dhe kthimi në familje i rezidentëve.

Aktualisht në Qendrën tonë marrin shërbim 29 rezidentë, prej të cilëve 21 përfitues janë mbi moshën 21 vjeçare, 15 janë të braktisur me vendim gjykate dhe 6 janë në interesim familjar. Shërbimi Social Shtetëror udhëzon që Qendrat Rezidenciale të ofrojnë kujdes dhe shërbim për rezidentët deri në moshën 21 vjeç, si dhe të kryhen të gjitha procedurat për kthimin në familje të personave me interesim. Konkretisht janë kryer të gjitha kërkesat dhe procedurat ndaj Shërbimit Social Shtetëror dhe Rajonal për sistemimin e këtyre rezidentëve, por situacionet social-ekonomike të familjeve të tyre nuk i plotësojnë kushtet për deinstitucionalizimin e këtyre përfituesve.

Realizimet e objektivave

1. Realizimet në sektorin social dhe pedagogjik

Në drejtim të këtyre sektorëve qëllimet, objektivat dhe aktivitetet përgjate këtij 4-mujori të 2025 ka qenë hartimi i Projektit mbi krijimin e Qendrës Ditore e cila do të zhvillohet në ambjentet e Qendres sonë. Jemi akoma në fazë transformimi dhe implementimi i Qendres së Përkujdesit Ditor. Ky është një projekt nisma e të cilit vjen nga Bashkia Vlorë në bashkëpunim me **Qendra per Drejtesi Gjimore**. Momentalisht jemi në fazën e krijimit të kushteve për përshtatjen e klasave. Një tjetër prioritet i është dhënë moshës në rritje të rezidentëve, të vështirësive që ata paraqesin nevojave dhe kërkesave të tyre në lidhje me trajtimin e aftësisë së kufizuar dhe të zhvillimit të tyre në përputhje me kërkesat dhe plotësimin e standarteve të vendosura.

Në nivel pedagogjik për kete vit jane vlerësuar fillimisht nevojat, kërkesat dhe vetë rezidentët brenda institucionit është hartuar një projekt pilot duke organizuar aktivitete okupacioni në bazë të trajnimeve speciale të edukatoreve të orientuara në aktivitete specifike. Që do të thotë se tashmë janë shtuar aktivitete paraprofesionale në mini atelie pune dhe punime kopshtarie : *punime me letër dhe plastikë, punime leshi, pikturë, aplikacione-prodhim piktura të ndryshme, mbjellia e luleve ,pastrimi i barërave të këqija etj.*

Aktivitet në Qendër janë zhvilluar normalisht.

Rezidentët përfshihen në këto aktivitete në mënyrën që munden . Këto aktivitete zhvillohen paralelisht me programet individuale të zhvillimit për gjithë secilin nga rezidentët.

Theksojmë se të gjitha aktivitetet janë realizuar në mbështetje të planeve të edukatoreve specialiste të cilët organizojnë punën në baze të prirjeve të secilit rezident.

Realizimi i objektivave pedagogjike

- Plotësimi i fshatit të vlerësimit të AK, për të përcaktuar nevojat dhe prioritetet e ndërhyrjes.
- Hartimi, plotësimi i planeve individuale të zhvillimit.
- Rishikimi dhe rivlerësimi i nevojave të rezidentëve përsa i përket moshës dhe tipologjisë së vështirësisë që ata paraqesin, duke i orientuar aktivitetet në ato paraprofesionale.
- Hapja e 2 mini-atelie të punës, e hekurosjes dhe e krijimtarisë me materiale të ndryshme sipas specifikave të rezidentëve.
- Trajnimi I stafit i cili do përfshihet në përkujdesin e Qendrës Ditore.

2. Ecuria shëndetësore e përfituesve

Përsa i përket gjendjes shëndetësore të rasteve, aktualisht janë 19 përfitues me mjekim ditor për shkak të çrregullimeve psikiatrike apo neurologjike. Mjekimi është i udhëzuar dhe dokumentuar nga mjeku specialist dhe menaxhohet nga infermieri i institucionit. Janë realizuar të gjitha ekzaminimet e udhëzuara nga mjeku.

Ushqimi është korrekt në lidhje me kuotën ushqimore të përcaktuar për secilin rezident dhe mund të vlerësohet një menu brenda parametrave normal përsa i përket kalorive duke përfshirë aty edhe moshën dhe dietën e rezidentëve.

Gjendja shëndetësore e rezidentëve ka qenë relativisht e mirë, duke patur parasysh këtë kategorinë e personave, problemet dhe vështirësitë që ata kanë.

Është bërë në mënyrë korrekte vaksinimi i rezidentëve sipas kalendarit të vaksinimit, si dhe kontrollet rutine përsa i përket planifikimit nga ana e infermieres në lidhje me kontaktimin me mjekët përkatës. Një tjetër prioritet është rinovimi i KMCAP.

2. Realizime në sektorin financiar.

Gjatë 2025 nga Bashkia na është akorduar një fond 30,506 /000(në mijëra) lekë i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Zërat	Plani vjetor 2025	Fakt 4-mujor -2025
600	18,000	5,481
601	3006	911
602	5000	667
231	4500	0
Totali	30,506	7,059

Veprimtaritë kryesore të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit bazuar në planin e masave janar-prill 2025

1. Aktivitetet dhe projektet e realizuara

- Mbështetja e OJF-ve dhe personave fizikë.
- Ofrimi i asistencës për aplikimin në projekte sipas thirrjeve nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
- Përgatitja dhe dorëzimi i shtatë projekt-propozimeve për aplikim pranë Ministrisë brenda afatit të përcaktuar, 7 shkurt 2025.
- Evidentimi i fasadave të pallateve në qytetin e Vlorës.
- Projekti “Murale që Transformojnë Bulevardin dhe Lagjet e Vjetra”.

Fokusi kryesor në lagjet dhe rrugicat e zonës së Çoles dhe Kumes si dhe dy të tjera: një te zona e Tregut të Orizit, një në fillim të Lungomares, që do të rikonceptohet si qendër atraktive për banorët dhe vizitorët.

2. Grumbullimi i të dhënave statistikore mbi turizmin

Të dhënat grumbullohen në mënyrë periodike nga institucionet e poshtëshënuara:

- Agjencia e Zonave të Mbrojtura
- Muzeu Kombëtar i Pavarësisë
- Muzeu Etnografik dhe Historik
- Porti i Vlorës
- Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore

Përpunimi dhe analizimi i informacionit të mbledhur për raportime të ndryshme.

3. Administrimi dhe menaxhimi i korrespondencës

- Kthimi i përgjigjeve për të gjitha shkresat brenda afateve ligjore.
- Mbajtja e korrespondencës dhe arkivimi i dokumenteve të drejtorisë.
- Hartimi i materialeve dhe analizave
- Përgatitja e dokumentacionit për Këshillin Bashkiak.

1. Aktivitetet dhe projektet e realizuara

- Mbështetja e OJF-ve dhe personave fizikë.
- Ofrimi i asistencës për aplikimin në projekte sipas thirrjeve nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
- Përpunimi instalacionit të Shën Valentinit dhe vendosja e tij në sheshin pranë stadiumit “Flamurtari”.
- Prezantimi i video-s në Ministrinë e Kulturës dhe Inovacionit, dhe aktivitetet që do zhvillohen gjatë intenerarit Giro d' Italia.
- Bashkëpunimi me Zyrën e Arsimit, komunikim me mësuesit e shkollave për pjesëmarrje në eventin e 7 Marsit.
- Organizimi logjistikë për aktivitetin artistik në panairin “ Lulet e Verës, në bashkëpunim me Zyrën Arsimore Vendore, Vlorë.
- Përpunimi i instalacioneve “50 Lule” në bashkëpunim me shkollën “ Pavarësia “ dhe vendosja e tyre në zona të ndryshme të qytetit si: Lungomare ,Sheshi “Pavarësia”, Rrethë rrotullimi në hyrjen e qytetit të Vlorës.
- Realizimi i koncertit me tre artistët e njohur si : Anxhela Peristere, Maya dhe Irma Libohova.
- Mbikëqyrje dhe përgatitje për lyerjen e fushës “Kinemaja Verore”.
- Trajnim Prema për “ Fuqizimin dhe Maksimizimin e Biznesit”.
- Pjesëmarrje në panairin e punës “ Panairi Ndërkombëtar të Turizmit – Kosova 2025, Edicioni i Katërt.

4. Pjesëmarrja Në Aktivitete Dhe Trajtime

- Trajnim në projektin: “Resilienza Marginale il modelo della circular economy per la valorizzazione delle vocazioni territoriali”
- Pjesëmarrje në panairin e punës “ Puno dhe Rritu” në datën 2 Mars ,Peshkopi.
- Pjesëmarrja në “ Ekspozitën Multimediale mbi Ndikimet e Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri”
- Pjesë e grupit të punës në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.83 datë 28.03.2025

“Mbi ngritjen e grupit të punës për inventarizimin e dokumentacionit të ndodhur në ambientet e nëndheshme të Bashkisë Vlorë.

- Pjesë në grupin e punës për inventarizimit e zyrave të Bashkisë.
- Pjesë e urdhërit të brendshëm Nr. 126 datë 16.04.2025 për ngritjen e grupit të punës së vlerësimit të ofertave për blerje pajisje në kuadër të projektit ART4SEA.
- Pjesë e urdhërit të brendshëm Nr.124 datë 16.04.2025 për ngritjen e grupit të punës së hartimit të termave të referencës për shërbim komunikim promovim dhe disemini në kuadër të projektit ART4SEA.
- Pjesë e urdhërit të brendshëm Nr. 128 datë 16.04.2025 për ngritjen e grupit të punës së hartimit të termave të referencës për shërbim organizimi ekspozitë virtuale në kuadër të projektit ART4SEA.
- Pjesë e urdhërit të brendshëm Nr. 121 datë 16.04.2025 për ngritjen e grupit të punës së hartimit të termave të referencës për shërbim organizim eventi në kuadër të projektit WRECKS4ALL.
- Përpunimi dhe dërgimi informacionit të eventeve për gjithë muajn Prill në Tourism Events Albania (TEA)
- Dorëzimi i projekteve nga aplikantët dhe kontrolli për saktësim dokumentacioni.
- Grumbullimi i projektetve dhe përpunimi i Memo-ve për cdo projekt të ardhur.
- Përpunimi dhe publikimi thirrjeve në datë 17.04.2025 për të dorëzuar projekt-propozimet e tyre.

Subjekti: Çelja e Sezonit Turistik 2025.

Hapja e sezonit turistik në qytetin e Vlorës është një ndër ngjarjet më të rëndësishme të vitit, e cila shënon nisjen e një periudhe të re energjie, vizitorësh dhe gjallërie në jetën urbane, kulturore dhe ekonomike të qytetit. Përmes kësaj thirrjeje, Bashkia e Vlorës synon të mbështesë projekte që promovojnë trashëgiminë kulturore, pasuritë natyrore, historinë dhe identitetin e Vlorës përmes formave të ndryshme të shprehjes artistike dhe veprimtarive kulturore.

- Përpunimi dhe publikimi i thirrjes në datë 07.04.2025. Për Aplikim Mbështetje Për Projektin “Spot Promovues – Giro d’Italia”

Subjekt : Spot Promovues për “Giro d’Italia”

- Përpunimi dhe publikimi i thirrjes në datë 16.04.2025

Subjekti: “Vlora Triathlon 2025”.

Vlora Triathlon 2025 është një garë e disiplinës triathlon (not, biçikletë dhe vrap) që planifikohet të zhvillohet në qytetin e Vlorës më 18 maj 2025. Ky event sportiv synon të bëhet një traditë e re vjetore në Vlorë, duke tërhequr sportistë profesionistë dhe amatorë nga brenda dhe jashtë vendit. Eventu do të shfrytëzojë peizazhin unik bregdetar të Vlorës për t’u ofruar garuesve dhe spektatorëve një eksperiencë të veçantë sportive dhe turistike.

- Komunikimi me bizneset për materiale në panairin e punës në datën 21 Mars, Peshkopi.

- Përpunimi dhe dërgimi informacionit të eventeve për gjithë muajn Mars në Tourism Events Albania (TEA)
- Përgatitja e relacionit për “ Ditën e Verës “, 14 Mars.
- Dorëzimi i projekteve nga aplikantët dhe kontrolli për saktësim dokumentacioni.
- Grumbullimi i projektetve dhe përpunimi i Memo-ve për cdo projekt të ardhur.

Aplikimi Për Mbështetjen Për Projekte Artistike- Kulture

- Përpunimi dhe publikimi thirrjeve në datë 10 Mars për të dorëzuar projekt-propozimet e tyre.

Subjekti: Koncert Festiv për ditën e Verës 14 Mars, për Bashkinë Vlorë.

Koncerti në kuadër të ‘ Ditës së Verës ’ në Vlorë, më 14 Mars, me tre këngëtar performues për të gjallëruar qytetin. Qëllimi i koncertit: Promovimi i traditave kulturore, argëtimi i qytetarëve dhe turisteve, dhe zhvillimin i turizmit në qytet.

ANALIZA E VEPRIMTARISË SË DREJTORISË SË BASHKËQEVERISJES

MISIONI:

Misioni i Drejtorisë së Bashkëqeverisjes është realizimi i një komunikimi të hapur dhe transparent me publikun e gjerë, duke i dhënë kështu institucionit të Bashkisë dimensionin real informues i cili do të shkojë paralel me punën që zhvillohet në qytet.

Detyrat e drejtorisë

Informon publikun për llojet e shërbimeve publike që ofrohen nga administrata e bashkisë, qëllimin e tyre, mundësinë e përfitimit të tyre , dokumentacionin që duhet të sigurohet, me qëllim marrjen e shërbimit , procedurat që duhen ndjekur, llojet e vendimarrjes gjatë procesit të dhënies së shërbimit dhe mundësinë për ankim.

Përcjell pranë strukturave të Bashkisë Vlorë kërkesat dhe ankesat e qytetarit , lidhur me përmirësimin e cilësisë së proceseve administrative, komunikim i cili është në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve dhe të të drejtave të qytetarëve.

Merr masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik.

Baza ligjore :

Drejtoria e Bashkëqeverisjes ushtron veprimtarinë e saj bazuar në :

1. Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e administratës
2. Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”
3. Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
4. Ligjin Nr.119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar.
5. Ligjin Nr.146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik ”
6. Ligjin Nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale ” i ndryshuar

OBJEKTIVAT:

- Ofrimi i shërbimit për dhënien e informacionit sipas ligjit
- Garantimi i lehtësisë në njohjen e informacionit qe prodhohet ose mbahet nga Bashkia Vlorë për publikun.
- Respektimi i afateve ligjore në dhënien e informacionit të kërkuar nga subjektet e interesuar.

Llojet e shërbimeve sipas fushave

Kategorizimi është i rëndësishëm pasi ofron një qasje tjetër informacioni për listën e shërbimeve të ofruara nga bashkia.

- 1.Kërkesë për informacion
2. Kërkesë/Ankesë e përgjithshme
- 3.Kërkesë për dokumentacion
- 4.Leje/ Licenca/Autorizime/Vërtetime
- 5.Shërbime sociale
6. Administrimi dhe menaxhimi i institucioneve të arsimit parauniversitar
7. Shërbime në fushën e sigurisë publike

Prej periudhës Janar – Prill 2025, pranë Drejtorisë së Bashkëqeverisjes janë realizuar detyrat e mëposhtme:

Për Drejtorinë e Urbanistikës, janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për planin e përgjithshëm vendor, kopje dokumentacioni të sistemit e-leje.

Për Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për shpronësime, për konfirmime të kufitarëve në lidhje inventarin e pronave të paluajtshme.

Për Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për leje transporti, për leje parkimi, për leje taksish, për rinovim leje karburanti, për leje zhvarrimi, leje promocioni, autorizime të ndryshme. Janë marrë kërkesa të qytetarëve për bonus qiraje (subvencionimi i qirasë), për privatizim objekti, për banesat me kosto të ulët nga projekti i subvencionimit të interesave të kredive nga buxheti i shtetit, për sistemim ambjenti, për ndricim si dhe kërkesa për dokumentacion.

Për sa i përket programit për përfitimin e subvencionimit të qirasë dhe për banesat me kosto të ulët nga projekti i subvencionimit të interesave të kredive nga buxheti i shtetit është bërë njoftimi nga ana e Drejtorisë sonë në stendën e Bashkisë, në media dhe në faqen e web-it.

Në lidhje me Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për verifikim leje ndërtimi, ankesa për cënim prone, ndërtime pa leje.

Për Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion në lidhje me buxhetin, konfirmime dokumentesh.

Për Drejtorinë Juridike janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion.

Për Drejtorinë e të Ardhurave Vendore janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për rishikim të taksave vendore, për shfrytëzim të hapësirës publike me qëllime biznesi, dorëzim të fletëve të regjistrimit të subjekteve hoteliere.

Për Sektorin e pyjeve dhe kullotave, janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion/dokumentacion si dhe autorizim për ndërhyrje në fondin pyjor.

Për Drejtorinë Burimeve Njerëzore, janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për kopje dokumentacioni nga arkiva, aplikime për punësim dhe vërtetime.

Për Drejtorinë e Ndhmës dhe Shërbimit Social, janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, kërkesa dhe ankesa mbi ndihmën ekonomike.

Për Këshillin Bashkiak janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për tituj nderi, për emërtim rruge.

Për Rajonet janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacione të ndryshme dhe ankesa të ndryshme për hapje rruge, lirim hapësire dhe probleme infrastrukturore nëpër banesa.

Për Zyrën e Gjendjes Civile janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion/vërtetime.

Për Policinë Bashkiake janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion dhe kërkesë ankesa për cënim prone etj.

Për Drejtorinë e Mbrojtjes Civile janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion dhe kërkesa në raste fatkeqësish natyrore.

Për Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi janë marrë kërkesa të qytetarëve për rinovim certifikate nga MZSH.

Eshtë kryer korrespondenca duke përpiluar konfirmime të shkresave të ardhura nga institucione të ndryshme si: Zyra Përmbarimore Publike, Private , Shpallje të Gjykatave, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorive të Doganave etj.

Gjithashtu, është ndjekur korrespondenca dhe dhënia e përgjigjeve brenda afateve për kërkesat e ardhura nga institucionet, nëpërmjet Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE), sistemi elektronik e-albania.

Eshtë kryer shpallja dhe publikimi i akteve të ndryshme të institucionit, njoftime të drejtorive të ndryshme si shpronësime, njoftime vendim me gjobë, njoftime për mbledhjen e Këshillit, njoftime për konsultimin publik, vendimet e Këshillit të Bashkisë si dhe akte të tjera me interes të gjerë publik etj.


Përsa i përket kërkesave të regjistruara në regjistrin e posaçëm, sipas ligjit Nr.119/2014 “ Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, të cilat publikohen dhe përditësohen çdo 1 muaj në faqen zyrtare të Autoritetit Publik në rubrikën

“ Transparenca” si dhe është implementuar regjistri elektronik i kërkesave për informacion, i cili është i aksesueshëm nga qytetarët për dërgim të kërkesave për informacion në portalin Pyet shtetin.al dhe që monitorohet çdo ditë nga ana e Drejtorisë.

Përsa i përket numrit të kërkesë/ankesave të depozituara pranë Drejtorisë së Bashkëqeverisjes për periudhën kohore Janar – Prill 2025 nga ana e qytetarëve është si më poshtë:

1. Në muajin Janar numri i kërkesave është 396 (Treqind e nëntëdhjetë e gjashtë)
2. Në muajin Shkurt numri i kërkesave është 455 (Katërqind e pesëdhjetë e pesë)
3. Në muajin Mars numri i kërkesave është 419 (Katërqind e nëntëmbëdhjetë)
4. Në muajin Prill numri i kërkesave është 489 (Katërqind e tetëdhjetë e nëntë)

Fig.1 Numri i kërkesave për info/dok, periudha Janar-Prill 2025



Numri total i kërkesave është 1759 (Njëmijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë), nga të cilat 104 (Njëqind e katër), janë procedura punësimi.

KRYETAR

Ermal Dredha

